



NDËRVEPRIMI NJERËZ-KOMUNA NË KOHË KRIZE: STUDIM I RASTIT COVID-19

Gusht 2021



Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të respondentëve të anketës dhe pjesëmarrësve të grupeve të fokusit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së ose USAID-it.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	8
Pasqyrë e Vendimeve të Institucioneve të Kosovës deri në mars të vitit 2021	8
Gjetjet e hulumtimit	10
Profili i të anketuarve	10
Kënaqshmëria e njerëzve me përkrahjen dhe komunikimin komunal	12
Kënaqshmëria e njerëzve me angazhimin e tyre nga komunat	39
Ofrimi i shërbimeve të rregullta gjatë pandemisë dhe disponueshmëria e mjeteve	51
Përfundim	65
Shtojca 1 Metodologjia	67
Shtojca 2 Lista e Figurave	69
Shtojca 3 Lista e Tabelave	73
Shtojca 4 Karakteristikat Demografike të diskutimit në grupe fokusi	74

Përmbledhje ekzekutive

Komunat janë në linjën e parë të reagimit ndaj krizës me COVID-19. Ato jo vetëm janë faktorë kryesorë në zbatimin e masave të qeverisë, por edhe krijojnë politika nga poshtë-lart dhe strategji të reagimit ndaj COVID-19. Prandaj, është me rëndësi të madhe të kuptohen sfidat që disa nga komunat e Kosovës i përjetuan gjatë pandemisë. Ky hulumtim është bërë me 500 intervista anketuese dhe nëntë diskutime në grupe fokusi. Kombinimi i të dhënave sasiore dhe cilësore mundësoi një pasqyrë të shumanshme të nivelit të kënaqshmërisë së banorëve në Kosovë¹ në lidhje me mbështetjen komunale dhe komunikimin, angazhimin e njerëzve në çështjet komunale, si dhe ofrimin e shërbimeve publike dhe disponueshmërinë e burimeve në kontekstin e pandemisë COVID-19.

Në përgjithësi, të anketuarit e pesë komunave të përfaqësuara në këtë studim², ishin **më pak të kënaqur me mbështetjen komunale dhënë atyre** ose **familjeve të tyre** dhe komuniteteve të tyre (përkatësisht 52% dhe 42%), sesa të kënaqur (respektivisht 25% dhe 26%). Mesatarisht, burrat më shumë sesa gratë në përgjithësi ishin shumë të pakënaqur me mbështetjen komunale ndaj tyre vetë, familjeve të tyre ose komuniteteve të tyre. Diskutimi në grupe fokusi zbuloi se shumica e pjesëmarrësve kishin përshtypjen se komunat u përmbaheshin masave të vendosura nga qeveria, si disa prej tyre ndërmorën iniciativa për të ndihmuar ata që ishin prekur nga COVID-19, dezinfektuan hapësirat publike, shpërndanë ushqime ose ofruan pajisje personale mbrojtëse.

Të anketuarve që ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me përkrahjen komunale iu kërkua të jepnin ide se si ata, familjet e tyre dhe komunitetet do të mund të përkraheshin më mirë. Gati dy të tretat e të anketuarve (61%) theksuan që **komunat duhet të ofrojnë ndihmë financiare për ata që janë prekur nga COVID-19** si dhe për familjet në nevojë, **të shpërndajnë pako ushqimore e higjienike për familjet në nevojë** (15%), si dhe të **ofrojnë shërbime mjekësore e ilaçe pa pagesë** për të gjithë (9%).

Komunat duket të kenë arritur të mbajnë të informuar pjesën më të madhe të banorëve të tyre. Afro **54% të të gjithë të anketuarve ndjeheshin që janë mbajtur të informuar deri në një masë, ose tejet mirë të informuar** lidhur me pandeminë nga komunat e tyre. Kjo u konfirmua tutje edhe në diskutime në grupe fokusi. Përtej kësaj, 95% të shqiptarëve të Kosovës, por vetëm 74% e serbëve të Kosovës, theksuan që kanë marrë informata në gjuhën e tyre amtare. Diskutimet në grupe fokusi zbuluan se komunitetet jo-shumicë ishin të pakënaqura me këtë aspekt të ndarjes së informatave, si dhe ndjeheshin të diskriminuar kur materialet nuk ofroheshin në gjuhën e tyre amtare. Komunitetet jo-shumicë (serbët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, turqit e Kosovës, romët e Kosovës, ashkalinjtë e Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës) po ashtu nuk pëlqenin komunikimin e komunave që kryesisht përqendroheshin tek mediat sociale për informimin e banorëve të tyre, duke anashkaluar faqet dhe kanalet e tyre zyrtare, gjë që pengonte mbulimin e gjeneratave më të moshuara në mënyrë më efikase.

Vlen të përmendet se, mesatarisht, banorët ishin më mirë të informuar për pandeminë COVID-19 sesa që ishin të kënaqur me përpjekjet e komunave të tyre për të mbështetur njerëzit me mjete financiare, donacione në natyrë, ose me kanale të tjera që synonin zbutjen e ndikimit të COVID-19 në kushte shëndetësore dhe socio-ekonomike. **Shkalla mesatare e të informuarit nga komunat**

¹Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999)

² Fushë Kosovë, Podujevë, Prizren, Rahovec, dhe Zveçan

përkatëse për pandeminë COVID-19 është 3.3 pikë në të pesë komunat (në shkallë prej 1 deri në 5, ku 5 nënkupton që janë shumë mirë të informuar). **Shkalla mesatare e kënaqshmërisë me përkrahjen komunale të përfituar** për veten ose familjet e tyre shkon vetëm deri në 2.5 pikë, si krahasim.

Besueshmëria e përgjithshme e informatave të dhëna nga komunat mbi pandeminë COVID-19 përceptohej të ishte e kënaqshme. Në përgjithësi, 65% e të anketuarve në pesë komunat i besojnë deri diku informacionit që marrin nga komunat e tyre, ndërsa 15% e tyre i besojnë informacionit në masë edhe më të madhe. Përveç kësaj, 56% e të anketuarve i besojnë deri diku informacionit të marrë nga institucionet qendrore, ndërsa 20% shfaqnin besim në shkallë edhe më të lartë. **Shpalljet televizive lokale ose kombëtare, Facebook-u, si dhe familja dhe miqtë** janë tre burimet kryesore për informata lidhur me COVID-19 midis banorëve në të pesë komunat.

Banorët në Kosovë nuk priren të marrin pjesë në dëgjime publike komunale, të cilat janë mënyrë qenësore e obligim ligjor për të garantuar që planifikimi i buxhetit komunal të jetë në përputhje me pritjet e palëve të ndryshme të interesit, siç janë banorët, ndërmarrjet dhe subjektet tjera komunale. **Rreth dy të tretat e të anketuarve nuk mendonin që komunat e tyre kanë mbajtur ndonjë dëgjim publik para ose pas** shpërthimit të pandemisë COVID-19. Vetëm katër nga 33 persona që theksuan se kishin ditur për dëgjime publike thanë se kanë marrë pjesë në ndonjë prej tyre. Temat e trajtuara në ato dëgjime, sipas tyre, lidheshin me shqetësimet në lidhje me pandeminë COVID-19, furnizimin me ujë, ndriçimin publik si dhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Disa nga pjesëmarrësit në diskutimet në grupe fokusi po ashtu kanë marrë pjesë në dëgjimet publike. Ata që kishin marrë pjesë kryesisht kishin vendosur të diskutonin çështje që i preknin drejtpërdrejt, ose për të përfaqësuar organizata joqeveritare. Përgjithësisht, të anketuarit **thanë se nuk ishin mirë të informuar për dëgjimet publike, ndërsa disa po ashtu pranuan se nuk kishin shumë interesim për të marrë pjesë në to.**

Për të zbutur pasojat e COVID-19 në jetesën e tyre, **ndihma financiare për familjet në nevojë** dhe ato të prekura nga COVID-19 u përmend si prioritet kryesor nga të anketuarit, pasuar nga - nevoja për- **përforsimi dhe respektimi i masave parandaluese ndaj COVID-19.**

Më shumë **se gjysma e të gjithë të anketuarve besonin që burimet financiare dhe infrastrukture të komunave të tyre** për reagimin ndaj COVID-19 ishin të **mjaftueshme.** Rreth dy të tretat e të anketuarve thanë se **resurset njerëzore komunale ishin të mjaftueshme ose më se të mjaftueshme.**

Komunat janë të obliguara të ofrojnë shërbime publike, pavarësisht nga situata me të cilat ballafaqohen, siç është pandemia COVID-19. **Përgjithësisht, më se 70% dhe deri në 84% e të anketuarve thanë se komuna ishte efikase ose tejet efikase në ofrimin e shumicës së shërbimeve publike** si: menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi i ujërave të zeza, mirëmbajtja e rrugëve lokale, transporti lokal, ujësjellësi, mirëmbajtja e ndriçimit dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga Qendrat Mjekësore Familjare (QMF) përgjatë gjithë pandemisë. Megjithatë, vetëm gjysma ndanin të njëjtin mendim për pagesën e obligimeve të skemës sociale. Në diskutimet e grupeve të fokusit, disa pjesëmarrës besonin se komunat kishin buxhet të mjaftueshëm për të zbutur ndikimet e pandemisë, ndërsa të tjerët mendonin se burimet financiare nuk ishin të mjaftueshme. Një numër pjesëmarrësish po ashtu vunë në dukje se komunat shpesh kthejnë suficitet e tyre në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, gjë që kryesisht ndodh për shkak të planifikimit joadekuat të buxhetit, që nënkupton që suficiti do të mund të ishte rialokuar si pjesë e reagimit ndaj COVID-19.

Bazuar në këto gjetje, disa rekomandime që komunat duhet të marrin parasysh janë paraqitur më poshtë:

Ndihma financiare dhe subvencionet

- Ndihma financiare për individët në përgjithësi, e sidomos ata më të goditurit nga COVID-19, si dhe subvencionet për bizneset, janë përmendur si prioritet kryesorë që komunat duhet t'i kenë parasysh në përkrahjen e njerëzve dhe bizneseve që veprojnë në ato komuna. Është e qartë se njerëzit preferonin të subvencionoheshin drejtpërdrejt me para, pasi që do të blinin produkte dhe shërbime të ndryshme të përshtatura për nevojat e tyre specifike.

Kanalet e komunikimit dhe gjuha e përdorur

- Edhe pse disa të anketuar ishin më të kënaqur se të tjerët në lidhje me informacionin që morën nga komunat e tyre, ishte e qartë se disa grupe ishin mbuluar më shumë se të tjerët, për shkak të kanalit të komunikimit ose gjuhës së përdorur. Kështu, komunat duhet të përdorin më shumë faqet zyrtare të internetit për të informuar banorët e tyre. Gjithashtu, informatat duhet të ndahen në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë. Informatat po ashtu duhet të ofrohen në kanale televizive, media sociale si dhe mesazhe tekstuale për të mbuluar të gjitha etnitë dhe brezat. Mediat sociale janë mjet efektiv komunikimi, për të mbuluar gjeneratat e reja, por më pak efektive për të moshuarit dhe grupet e pakicave etnike. Prandaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kësaj çështjeje, si masë kujdesi për krizat e ardhshme të mundshme me të cilat mund të ballafaqohen komunat.

Angazhimi qytetar në vendimmarrjen komunale dhe prioritizimin e buxhetit

- Komunat në Kosovë janë të obliguara të mbajnë dëgjime publike³ për të diskutuar aktivitetet që duhet të përfshihen në buxhetin komunal, si dhe që të gjejnë kanale të duhura informimi për banorët e tyre. Megjithatë, hulumtimet tjera⁴, por edhe gjetjet e këtij raporti tregojnë se mosangazhimi qytetar në dëgjimet publike, apo mënyra të tjera të konsultimeve publike, ndodh për shkak se banorët nuk kontaktohen aq mirë, apo edhe nuk janë të interesuar. Gjendja nuk dukej të ishte ndryshe para apo pas shpërthimit të COVID-19. Kështu, ekziston nevoja për fushata ndërgjegjësimi të ndërhuara enkas për qëllimin dhe rëndësinë e dëgjimeve publike lokale, si dhe kanale më të mira informimi.

Komunat duhet të postojnë informatat me kohë në të gjitha gjuhët zyrtare, në faqet e tyre zyrtare komunale dhe në media sociale, si dhe të dërgojnë emaila apo SMS gruporë. Për më tepër, për të rritur besimin e njerëzve se zëri i tyre dëgjohej, komunat duhet të publikojnë procesverbale e informata të mbledhjeve mbi çështjet që janë propozuar nga banorët e që janë marrë apo nuk janë marrë parasysh, bashkë me arsyetimin se pse ato çështje nuk janë adresuar. Si mësim i nxjerrë nga kriza, për të siguruar pjesëmarrje më të madhe, dëgjimet publike potencialisht mund të digjitalizohen, plotësisht ose së paku pjesërisht, me anë të platformave virtuale. Për më tepër, kombinimi i veglave e qasjeve të ndryshme (si ato tradicionale ashtu edhe mënyrat moderne të angazhimit) për të krijuar plane më sistematike për angazhimin e banorëve mundet - e edhe shkon përtej - të krijojë ndërveprim shumë më të qëndrueshëm, gjë që në anën tjetër, në afat të mesëm, mund të ndikojë pozitivisht edhe në planifikimin dhe përcaktimin e prioritetëve në nivel komunal.

Burimet Financiare, Infrastrukturore dhe Njerëzore dhe Ofrimi i Shërbimeve Publike

³ GZRKS. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë, Neni 61. <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12387>>

⁴ Instituti Demokratik i Kosovës "Procesi i hartimit të Buxheteve Komunale në Kosovë", 2019. <<https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/02/Municipal-Budget-Development-Process-in-Kosovo-ENG-me-ISBN.pdf>>

- Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve kishin mendimin se komunat kishin burime të mjaftueshme financiare (52%), burime njerëzore (65%) dhe burime infrastrukturore (72%); megjithatë, disa besonin të kundërtën, ndërsa shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusit mendonin po ashtu se buxheti që marrin komunat e tyre nuk pasqyron numrin e vërtetë të banorëve të komunës së caktuar, e as nevojat e tyre. Përfaqësuesit komunalë e theksuan këtë çështje edhe gjatë diskutimeve. Prandaj, nevojitet përgatitje më e mirë dhe më efikase në aspektin e planifikimit buxhetor. Në anën tjetër, kjo mund të përdoret në mënyrë proaktive nga Ministria e Financave për të përforcuar alokimet buxhetore në drejtim të shënjestrimit dhe identifikimit të çështjeve, e jo me ndarje të përgjithshme për komunat. Vendim-marrja e bazuar në të dhëna mund të përforcohet më shumë nëse ka bazë dhe shfrytëzon përlllogaritjet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për të përplotësuar të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Për më tepër, komunat duhet të përqendrohen në investime në digjitalizimin e shumicës së shërbimeve, për të siguruar efektshmëri më të lartë kur është e mundur, ndërsa hartojnë plane për të tkurrur efektivisht mangësitë digjitale. Për sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore, komunat duhet të mendojnë rritjen e stafit të specializuar dhe krijimin e më shumë qendrave të mjekësisë familjare (QMF) për të mbuluar zonat urbane dhe rurale. Transparenca në shpërndarjen e pagesave të skemave sociale duhet të sigurohet duke publikuar listat e përfituesve në kohën e duhur, si dhe me shpjegime për kriteret e zbatuara, në faqet zyrtare të komunave. Komunat duhet të krijojnë mekanizma më të mirë inspektues dhe sisteme të llogaridhënies me kompanitë e kontraktuara për shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, ndriçimin publik dhe zhvillimin e infrastrukturave tjera.

Komunat nuk mund t'i bëjnë të gjitha këto vetë. Rimëkëmbja nga kriza është një shqetësim i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes, e kështu, institucionet e nivelit lokal dhe qendror duhet të punojnë së bashku për të siguruar burime të duhura financiare dhe qeverisje të mirë për të ofruar mundësi për të gjithë, për të përmirësuar mirëqenien e banorëve, si dhe për të nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës në të ardhmen.

Hyrje

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit shpalli COVID-19 si pandemi globale. Më 13 mars 2020, Kosova zbuloi dy rastet e para të infektimit me COVID-19. Që atëherë, pandemia ka shkaktuar një numër të konsiderueshëm të vdekjeve, si dhe pasoja ekonomike dhe sociale.

Përhapja e pandemisë COVID-19 solli sfida të pashembullta ndaj ofrimit të shërbimeve publike në nivel lokal, si dhe në mbarë Kosovën. Institucionet e Kosovës dhe njerëzit kanë përballur sfida në sigurimin dhe qasjen në kujdesin shëndetësor, ushqim, mbështetje emocionale dhe psikologjike, të cilat çuan në pasiguri ekonomike. Megjithëse shumë biznese u mbyllën plotësisht ose pjesërisht për të parandaluar përhapjen e infeksioneve të reja, shërbimet themelore publike vazhduan të ofroheshin.

Komunat në Kosovë kanë mandat të menaxhojnë një sërë shërbimesh publike, si menaxhimi i mbeturinave, ujësjellësi, menaxhimi i ujërave të zeza, mirëmbajtja e rrugëve lokale, mirëmbajtja e ndriçimit të rrugëve, siguri i transportit lokal, pagesa e detyrimeve të skemave sociale dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor përmes QMF-ve, ndër të tjera.

Higjiena e përgjithshme, si: uji i pastër, menaxhimi i mirëfilltë i ujërave të dhe mbeturinave, që ofrohet nga institucionet e shërbimit publik, mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në frenimin e përhapjes së virusit. Pavarësisht nga sfidat që mund të shfaqen në shërbimet publike, siç janë rreziqet financiare dhe shëndetësore të shkaktuara nga pandemia, këto shërbime sanitare duhet të jenë të detyrueshme për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së mëtejshme të virusit në publik.

UNDP ka porositur këtë hulumtim për të kuptuar kapacitetet e institucioneve lokale në Kosovë në menaxhim të krizave, si dhe në ofrim të shërbimeve publike. Përmes një ankete të opinionit publik, që përmbante nëntë grupe fokusi me banorët e komunave, si dhe pesë grupe fokusi me përfaqësues komunalë, u analizua niveli i kënaqshmërisë; komunikimi dhe përkrahja që kanë ofruar komunat që nga shpërthimi i COVID-19 në Kosovë, si dhe u analizuan sfidat me të cilat komunat janë përballur.

Ky raport ofron një vlerësim të përpjekjeve që janë bërë nga komunat Fushë Kosovë, Podujevë, Prizren, Rahovec e Zveçan për të angazhuar banorët e tyre në aktivitetet e luftimit të COVID-19 si dhe në ofrimin e shërbimeve publike për ta. Informatat e shtjelluara në këtë raport trajtojnë mënyrën se si komunat i janë përgjigjur krizës që nga marsi 2020 deri në mars të vitit 2021.

Ndërsa të dhënat e sondazhit janë grumbulluar në mars të vitit 2021, të dhënat e grupeve të fokusit janë mbledhur nga prilli deri në qershor të vitit 2021. Pyetjet trajtonin perceptimet dhe përvojat e të anketuarve për periudhën njëvjeçare, edhe pse pjesëmarrësit në grupet e fokusit nganjëherë flisnin për ngjarje edhe jashtë asaj periudhe kohore kur shprehnin mendimet e tyre.

Pasqyrë e Vendimeve të Institucioneve të Kosovës deri në mars të vitit 2021

Për të kuptuar kontekstin në të cilin komunat duhej të vepronin, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje pasqyrës së vendimeve të institucioneve të Kosovës të marra në nivel qendror gjatë periudhës kohore të kryerjes së anketës.

Kosova shënoi dy rastet e para me COVID-19 më 13 mars 2020, si dhe dy ditë më vonë, shpalli emergjencën të shëndetit publik.⁵ Më vonë atë muaj, kabineti ekzekutiv mbylli shkollat dhe

⁵ Vendimi i Qeverisë (mars 2020) gjendet tek: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr-01-11.pdf>

institucionet e tjera arsimore, mbylli kufijtë tokësorë dhe kufizoi udhëtimet brenda Kosovës. Bizneset shërbyese, si gastronomia, palestrat dhe qendrat tregtare u detyruan të pezullonin veprimtarinë e tyre. Vetëm shërbimet esenciale, si supermarketet dhe farmacitë, u lejuan të funksiononin. Kompanitë udhëzuan punonjësit që të punojnë nga shtëpia, kurdo që ishte e mundur. Transporti publik urban nga një komunë në tjetrën u ndërpre, ndërsa kabineti ekzekutiv vendosi orën policore nga ora 17:00 deri në 06:00.

Për të lehtësuar problemet që rrodhën nga masat kufizuese, kabineti ekzekutiv miratoi Pakon Fiskale Emergjente kah fundi i muajit mars 2020. Pakoja dyfishoi pagesat e skemës pensionale për përfituesit, ofroi mbështetje financiare për bizneset, duke ofruar kredi pa interes, ofroi përkrahje financiare për komunitat, si dhe rriti buxhetin për ministritë.⁶ Mësimi virtual në të gjitha nivelet e arsimit u ofrua përmes transmetuesit publik.

Derisa numri i rasteve me COVID-19 u ul gjatë karantinës, kabineti ekzekutiv urdhëroi rihapjen graduale të shoqërisë gjatë majit 2020. Një muaj më vonë, pothuajse të gjitha kufizimet u hoqën, por distancimi fizik, mbajtja e maskave dhe ndalimi i tubimeve të mëdha mbetën në zbatim. Kopshtet private dhe publike filluan të funksionojnë dhe u hapën kufijtë tokësorë.

Sidoqoftë, në korrik të vitit 2020, Kosova shënoi rritje të rasteve me COVID-19. Kabineti ekzekutiv vendosi masa të reja, të cilat përfshinin orën policore gjatë natës, mbajtjen e maskave, etj. Muajin vijues (gusht 2020), u miratuan Ligji për Parandalimin e Përhapjes së COVID-19, Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2020, si dhe Master Plani për Zhvillimin e mësimin në kushte të pandemisë 2020-2021. Në shtator të vitit 2020, kabineti ekzekutiv hapi institucionet arsimore, si dhe iu kthye mësimin në klasa, me një sistem rotacioni, që kombinonte orët virtuale dhe ato fizike.

Fatkeqësisht, gjendja u përkeqësua me infektimet e reja me COVID-19, gjë që shkaktoi një numër të konsiderueshëm të vdekjeve. Në tetor të vitit 2020, kabineti ekzekutiv riktheu masat e mëparshme (të tilla si distancimi fizik, mbajtja e maskave), si dhe vendosi masa të reja, me orë policore më strikte për komunitat me numrin më të lartë të rasteve pozitive dhe për personat në grupe me rrezikshmëri të lartë - si të moshuarit.

Deri në muajt nëntor e dhjetor 2020, komunitat u ndanë në tri zona, bazuar në numrin e konfirmuar të rasteve të reja ditore me COVID-19. **Komunitat e zonës së gjelbër** (75 infeksione ditore për 100,000 banorë) urdhëronin mbylljen e bizneseve në orën 20:00, restorantet mund të punonin për dërgesa dhe marrje me vete edhe më vonë. Në **komunitat e zonës së verdhë** (76-150 infeksione ditore për 100,000 banorë), bizneset mbylleshin në orën 18:00, restorantet mund të vazhdonin punën për dërgesa dhe marrje me vete. Në **komunitat e zonës së kuqe** (150 infeksione ditore për 100,000 banorë), kishte orë policore 19:00-05:00 për të gjithë banorët, përveç rasteve shëndetësore dhe emergjente, bizneset duhej të mbylleshin në orën 18:00, restorantet mund të punonin për dërgesa dhe marrje me vete edhe më vonë⁷. Lista vazhdonte të ndryshonte, por komunitat në këtë studim kanë qenë në të tri zonat në periudha të ndryshme.

⁶ Vendimi i Qeverisë (mars 2020) gjendet tek <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf> and <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendim-i-Mbledhjes-s%C3%AB-16-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

⁷ Kosovë: Autoritetet freskojnë listën e komunave me aktivitet të shtuar me COVID-19 më 4 dhjetor / shpallja për 15 (dhjetor 2020) gjendet tek: <https://www.garda.com/crisis24/news-alerts/407811/kosovo-authorities-update-list-of-municipalities-with-increased-covid-19-activity-as-of-december-4-update-15>

Përfundimisht, në fund të vitit, Kuvendi miratoi "Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike", i cili, përveç masave të ndryshme që synonin mbështetjen e ndërmarrjeve kosovare, krijoi edhe një fond të ndihmës për papunësi, në shumë prej 30 milionë euro. Në janar të vitit 2021, u miratua edhe Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike, që përfshinte planin e rimëkëmbjes prej 222.5 milionë eurosh, i cili u përdor kryesisht për të mbështetur sektorin e shëndetësisë, policinë dhe familjet me të ardhura të ulëta.⁸

Në shkurt të vitit 2021, kabineti ekzekutiv i Kosovës vendosi⁹ të hiqte orën policore, ndërsa institucionet arsimore rifilluan mësimin me prezencë fizike, bizneset u lejuan të operonin deri në orën 22:00, punonjësit u këshilluan të punonin në distancë kur ishte e mundur, si dhe të zbatonin udhëzimet për mbrojtje kundër përhapjes së COVID-19. Bizneset kishin orare pune më të gjata, biznese të caktuara si kinematë operonin me 40% kapacitet, transporti publik me gjysmën e kapacitetit.¹⁰ Vendimet mbetën në fuqi deri në fund të marsit 2021, kur rastet pozitive të COVID-19 shkonin nga 700 deri në 800 në ditë.¹¹

Kah fundi i marsit 2021, Kosova filloi vaksinimin e popullatës së saj, me përkrahje nga donacione të ndryshme.¹² Personeli mjekësor dhe të moshuarit në grupmoshën 80 vjeç e sipër ishin prioritet.¹³ Kabineti ekzekutiv i Kosovës ka vendosur masa të ndryshme për të luftuar COVID-19, si dhe efektin e pandemisë në aspektin e shëndetit dhe mirëqenies socio-ekonomike. Gjithashtu, partnerët ndërkombëtarë zhvillimorë kanë mbështetur Kosovën në këto kohë sfiduese. Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë nivelin e kënaqshmërisë së njerëzve dhe nxjerrin mësimet se si të përgatitemi më mirë për emergjencat dhe krizat e shëndetit publik.

Gjetjet e hulumtimit

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet nga anketa me 500 banorë nga pesë komuna dhe 14 grupe fokusi. Detajet e karakteristikave demografike të pjesëmarrësve në grupet e fokusit janë dhënë në shtojcë të këtij raporti.

Profili i të anketuarve

Profili i të anketuarve në sondazh korrespondon me mostrën kuotë të shpjeguar në pjesën e metodologjisë dhe procedurën e ponderimit (shih Shtojcën 1 për detaje), ndërsa karakteristikat demografike përafrohen me përbërjen e popullsisë së të gjithë Kosovës, pasi që metoda e grumbullimit të të dhënave është bërë përmes mostrimit me grupim në shumë faza, me stratifikim. Rrjedhimisht, 53% e të anketuarve janë gra dhe 47% e të anketuarve janë burra. Përafërsisht me shpërndarjen e moshave të të gjithë popullsisë së Kosovës, si dhe me variacionet komunale të marra parasysh, 20.2% e të anketuarve janë 18-24 vjeç, 21.4% e të anketuarve janë 25-34 vjeç, 17.6% e të

⁸ Kosova miraton pakon e rimëkëmbjes me 222.4 milionë € për vitin 2021 (janar 2021), gjendet tek:

<https://www.intellinews.com/index.php/kosovo-approves-222-4mn-recovery-package-for-2021-200482/?source=kosovo>

⁹ UNKT, Rikapitulim i vendimeve të qeverisë (shkurt 2021) gjendet tek:

<https://drive.google.com/file/d/1mLCGV0Bvgtf91aKvxocwk5PiDmV2U6Jc/view>

¹⁰ UNKT, Rikapitulim i vendimeve të qeverisë (shkurt 2021) gjendet tek:

<https://drive.google.com/file/d/1mLCGV0Bvgtf91aKvxocwk5PiDmV2U6Jc/view>

¹¹ Qendra e situatave, UNKT COVID-19, edicioni 60, (Mars 2021) gjendet tek:


<https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-03/SITREP%2060%20-%20Kosovo%20-26032021.pdf>

¹² Ministria e Shëndetësisë në Kosovë, (mars 2021) gjendet tek: <https://msh.rks-gov.net/sq/kosova-ka-nisur-sot-vaksinimin-kunder-covid-19/>

¹³ Reuters, (mars 2021), gjendet tek: <https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-kosovo-vaccine-idUSKBN2BL2BI>


anketuarve janë 35-44 vjeç, 18.5% e të anketuarve janë 45-55 vjeç, 12.4% e të anketuarve janë 55-64 vjeç, ndërsa 9.9% e të anketuarve janë 65 vjeç e lart. Rreth 63% e të anketuarve përfaqësojnë rajonin e Prizrenit, përkatësisht komunat Prizren dhe Rahovec, 33% përfaqësojnë rajonin e Prishtinës, përkatësisht komunat Fushë Kosovë dhe Podujevë, ndërsa 4% përfaqësojnë rajonin e Mitrovicës, përkatësisht komuna e Zveçanit.

Figura 1 Profili i të anketuarve sipas gjinisë
 Figura 2 Profili i të anketuarve sipas moshës
 Figura 3 Profili i të anketuarve sipas rajonit



Për më tepër, 60% e të anketuarve banojnë në zona rurale dhe 40% në zona urbane. Sa i përket nivelit të shkollimit të përfunduar, 4.7% e të anketuarve nuk kanë përfunduar asnjë nivel shkollimi, 33.4% kanë përfunduar arsimin fillor, 45.3% kanë përfunduar arsimin e mesëm, 14.1% kanë diplomë bachelor ose ekuivalente, ndërsa 2.5% kanë përfunduar studimet Master ose PhD.

Figura 4 Profili i të anketuarve sipas llojit të vendbanimit
 Figura 5 Profili i të anketuarve sipas shkollimit



Në aspektin e përkatësisë etnike, 90% e të anketuarve janë shqiptarë të Kosovës, 6% janë serbë të Kosovës dhe 4% janë të etnive të tjera. Sa i përket statusit të punësimit, 23.2% e të anketuarve punojnë me orar të plotë, 2.8% punojnë me gjysmë orari, 3.9% janë të vetëpunësuar dhe 1.3% janë bujq. Rreth 24.8% e të anketuarve janë të papunë, 26.1% e të anketuarve janë amvisë, 9.1% janë në pension, 8.2% janë studentë dhe 0.5% janë me aftësi të kufizuara. Në aspektin e statusit martesor, dy të tretat e të anketuarve (66%) janë të martuar, 27.7% e tyre janë beqarë, 4.7% janë të vejë, 1% bashkëjetojnë me një partner, ndërsa 0.6% janë të divorcuar.

Figura 6 Profili i të anketuarve sipas Etnisë




Figura 7 Profili i të anketuarve sipas Punësimit





Figura 8 Profili i të anketuarve sipas gjendjes martesore



Kënaqshmëria e njerëzve me përkrahjen dhe komunikimin komunal

Moduli i parë i anketës trajtoi kënaqshmërinë e të anketuarve me përkrahjen dhe komunikimin e komunave të tyre gjatë pandemisë COVID-19.

Në përgjithësi, gjetjet nga të dhënat e anketës tregojnë se banorët shpesh ishin të pakënaqur me mënyrat¹⁴ në të cilat komuna i përkrahte ata dhe familjet e tyre. Kjo është e dukshme në të gjitha komunat e anketuara, por veçanërisht nga Rahoveci, ku gati dy të tretat ishin ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur. Perceptimi mbi atë se sa komunitetet në tërësi janë përkrahur nga komunat e tyre përkatëse ishte pak më pozitiv, ndërsa diskutimi në grupe fokusi shfaqti perceptime të ndryshme mbi atë nëse komunat kishin arritur t'i krijonin ndjenjën banorëve dhe komuniteteve të tyre që janë të përkrahur.

Shumë të anketuar kanë theksuar mungesën e ndihmës financiare për familjet e prekura nga pandemia. Banorët e komunës së Prizrenit u dalluan në këtë drejtim, pra kishte më shumë banorë që mendonin se kishte munguar edhe shpërndarja e pakove ushqimore e higjienike për familjet në nevojë.

Niveli i njohurive për nismat komunale që synojnë trajtimin e COVID-19 ishte i dobët në mesin e të anketuarve. Megjithatë, disa nga gjetjet e grupeve të fokusit, nga diskutimet e zhvilluara me përfaqësuesit komunalë, janë në kundërtënie të drejtpërdrejtë me këto rezultate të anketës; përfaqësuesit mendonin se komunat e tyre kanë zbatuar një numër nismash të suksesshme. Për më tepër, disa pjesëmarrës nga grupet e fokusit me banorë po ashtu theksuan se komuna e tyre e ka menaxhuar mirë pandeminë, përmes nismave të ndryshme.

Kjo mospërputhje mund të shpjegohet përmes gjetjeve të tjera nga diskutimet në grupe fokusi; disa banorë theksonin mungesën e materialit informativ në gjuhët e grupeve minoritare dhe ofrimin (e perceptuar si) të paorganizuar të informatave në lidhje me iniciativat, si pengesa kryesore në informimin e njerëzve.

Shpërndarja e përgjithshme e informatave lidhur me pandeminë COVID-19, në anën tjetër, duket se është menaxhuar mirë, ose në mënyra të pranueshme (neutrale), nga komunat. Shumica e të anketuarve ndjeheshim shumë mirë ose mirë të informuar, si dhe e perceptonin informacionin si të


¹⁴ Mjete financiare, donacione në natyrë, në çdo mënyrë tjetër

besueshëm dhe të lehtë për t'u kuptuar. Në përgjithësi, mund të vërehet se niveli i kënaqshmërisë me ndarjen e informatave qëndron më lartë se kënaqshmëria me iniciativat e ndërmarra nga komunat.

Të anketuarit më së shpeshti marrin informatat në fjalë përmes njoftimeve televizive ose mediave sociale, si dhe nga komunitetet e tyre (familja dhe miqtë). Duhet të theksohet se mbështetja tek njohuritë e komunitetit ishte posaçërisht e përhapur tek banorët e Podujevës, si dhe tek të anketurit e moshuar në përgjithësi, ku këta të fundit i përdorin po ashtu më rrallë mediat sociale për të marrë informata. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve serbë të Kosovës (19%) deklaruan se materiali i përgjithshëm informues për COVID-19 nuk ishte ofruar në gjuhën e tyre amtare.

Kur të anketuarit u pyetën nëse ishin të kënaqur apo të pakënaqur me mënyrën se si komuna i ka përkrahur **ata ose familjet e tyre**, financiarisht apo me donacione në natyrë, gjatë pandemisë COVID-19, 52% e të anketuarve raportuan se ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur, ndërsa rreth 25% e tyre ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur. Të ndara në komuna, 33% e të anketuarve në Podujevë, 36% e të anketuarve në Zveçan, 56% e të anketuarve në Fushë Kosovë, 59% e të anketuarve në Prizren, si dhe 62% e të anketuarve në Rahovec ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur.


Figura 9 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave



Raportimi i këtyre rezultateve në përpjesë shkalle, ku nota 1 nënkupton "shumë i/e pakënaqur" dhe 5 është "shumë i/e kënaqur", kënaqshmëria me përkrahjen komunale, për veten ose familjet, është mesatarisht 2.5 pikë, përfshirë të pesë komunat. Mesatarja për Podujevën është 2.8 pikë, për Zveçanin 2.7 pikë, për Prizrenin 2.5 pikë, për Fushë Kosovën 2.3 pikë, si dhe për Rahovecin 2.2 pikë.


Figura 10 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5

pikësh



Raporti po ashtu hulumton nëse ka ndonjë dallim në kënaqshmërinë e të anketuarve me komunat e tyre në bazë të gjinisë. Më shumë burra nga Podujeva (26%), Rahoveci (44%), si dhe Fushë Kosova (46%) ishin shumë të pakënaqur me përkrahjen komunale, krahasuar me gratë nga ato komuna (20%, 41%, 33% respektivisht), ndërsa më shumë gra nga Prizreni (19%) dhe Zveçani (27%) ishin shumë të pakënaqura me përkrahjen komunale, krahasuar me burrat (17% dhe 15%, respektivisht).


Figura 11 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas gjinisë



Kur krahasohen me të ardhurat mujore të familjes, shumica e njerëzve nga të gjitha komunat, që ishin shumë të pakënaqur, ishin ata që fitojnë 0-249 euro në muaj, pasuar nga ata që fitojnë 250-299 euro në muaj, pastaj nga ata që fitojnë 400-799 euro në muaj, e së fundmi nga ata që fitojnë 800-2000 euro në muaj si familje. Këto rezultate tregojnë deri në një farë mase se sa më të pakta të jenë të ardhurat familjare, aq më shumë gjasa ka që të anketuarit të jenë shumë të pakënaqur me


përkrahjen financiare ose në natyrë të komunave. Sidoqoftë, duhet të theksohet se ka pasur pak më shumë të anketuar të pakënaqur në kategorinë e tretë të të ardhurave familjare sesa në të dytin.

Figura 12 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas të ardhurave mujore të familjes



Të anketuarve më pas iu kërkua të vlerësojnë nivelin e kënaqshmërisë dhe pakënaqësisë së tyre me përkrahjen komunale gjatë pandemisë COVID-19 për sa i përket **komunitetit të tyre**. Të anketuarit e të gjitha komunave mendonin se komunat e tyre kishin qenë më ndihmuese me përkrahjen financiare ose në natyrë për komunitetet e tyre në përgjithësi, sesa për veten apo familjet e tyre. Në këtë drejtim, 42% e të anketuarve të të pesë komunave ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me përkrahjen e komunës ndaj komuniteteve të tyre (10% më e ulët se përkrahja që kishin marrë për vete) dhe 26% e tyre ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur. Më shumë të anketuar ishin neutralë (29%) kur krahasoheshin me përkrahjen që i ishte ofruar atyre vetë dhe familjeve të tyre (22%). Të ndarë në komuna, 22% e të anketuarve në Zveçan, 31% e të anketuarve në Podujevë, 34% e të anketuarve në Prizren, 52% e të anketuarve në Fushë Kosovë, si dhe 56% e të anketuarve në Rahovec ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur.


Figura 13 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave



Në shkallën prej 1-5, ku nota 1 nënkupton "shumë i/e pakënaqur" dhe 5 është "shumë i/e kënaqur", kënaqshmëria me përkrahjen komunale të ofruar për veten ose familjet e tyre, është mesatarisht 2.6


pikë, ku përfshihen të pesë komunat (pak më shumë sesa për veten apo familjet). Mesatarja për Zveçanin është 3.0 pikë, për Podujevën 2.8 pikë, për Prizrenin 2.6 pikë, për Fushë Kosovën 2.4 pikë, si dhe për Rahovecin 2.3 pikë.

Figura 14 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) **juve apo familjen tuaj** gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh



Kishte disa dallime varësisht nga gjinia, kur të anketuarit u pyetën për nivelin e kënaqshmërisë së mbështetjes komunale të ofruar për komunitetet e tyre. Më shumë burra nga pothuajse të gjitha komunat, përkatësisht Zveçani (13%), Prizreni (15%), Podujeva (26%), si dhe Fushë Kosova (40%) ishin **shumë të pakënaqur** me përkrahjen komunale, krahasuar me gratë nga ato komuna (përkatësisht 9%, 22%, 14% dhe 28%). Nga ana tjetër, burrat dhe gratë ishin po aq të pakënaqur me përkrahjen komunale ndaj komuniteteve të tyre (38% për të dy kategoritë) në Rahovec.

Figura 15 Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) **juve apo familjen tuaj** gjatë pandemisë COVID-19? – sipas gjinisë



Në shtjellim të mëtutjeshëm të këtyre rezultateve, diskutimet në grupe fokusi me banorët e secilës komunë, si dhe me zyrtarët komunalë si dhe anëtarët e kuvendeve, ofruan informata të paçmueshme lidhur me detajet e ballafaqimit me pandeminë në nivel lokal.

Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit në grupin e fokusit në Podujevë u shprehën pjesërisht të kënaqur me mënyrën se si komuna e tyre ka menaxhuar situatën pandemike. Disa prej tyre përmendën faktin se gjatë pandemisë, komuna drejtohej pa kryetar komune dhe duhej të përgatitej për zgjedhjet komunale, gjëra këto që ndikuan në efikasitetin e administratës komunale. Ndërsa shumica deklaroi se janë të kënaqur me reagimin ndaj pandemisë, duke marrë parasysh kapacitetet komunale, ata po ashtu pranuan se gjithmonë ka vend për përmirësim.

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit shqipfolës të grupeve të fokusit në Fushë Kosovë ndanin mendimin se komuna e tyre nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të veçantë në parandalimin apo zbutjen e ndikimeve të shkaktuara nga COVID-19. Ndërsa disa pjesëmarrës mendonin se komunat e tyre kishin reaguar në mënyrë të duhur ndaj pandemisë, të tjerët thonin se komuna e tyre nuk i ka përmbushur detyrimet e saj në lidhje me menaxhimin e pandemisë me mënyrën dhe seriozitetin e duhur. Pakënaqësi u vërejtën edhe në mesin e pjesëmarrësve në grupin e fokusit serbisht-folës, të cilët mendonin se komuna nuk kishte marrë iniciativë të mjaftueshme për të zbutur ndikimin e pandemisë COVID-19.

Në grupet serbo-folëse, serbët e Kosovës dhe goranët e Kosovës dalloheshin kryesisht duke mos qenë të kënaqur me nismat komunale, ndërsa boshnjakët e Kosovës ishin të kënaqur deri diku. Çështja më e madhe ishte mospërdorimi i gjuhës serbe dhe atyre të pakicave të tjera, që kishte privuar shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë nga përkrahja e nevojshme.


Shumica e pjesëmarrësve në grupin e fokusit shqipfolës në Rahovec besonin se komuna e tyre kishte arritur të reagojë në mënyrë adekuate ndaj nevojave që u paraqitën në kontekstin e pandemisë. Pjesëmarrësit në grupin serbofolës kryesisht mendonin se kishte mungesë të informacionit në lidhje me cilëndo iniciativë të ndërmarrë nga komunat e tyre. Nuk ka media në gjuhën serbe në Rahovec, prandaj i gjithë informacioni është shpërndarë ose përmes mediave sociale ose gojarisht nga një person tek tjetri, sipas pjesëmarrësve. Sipas disa pjesëmarrësve serbë dhe shqiptarë të Kosovës, nuk kishte përkrahje të organizuar mjekësore për ata që vuanin nga COVID-19, ndërsa të gjitha shpenzimet për trajtim duheshin mbuluar paraprakisht nga pacienti.

Në përgjithësi, të dy grupet e fokusit me pjesëmarrës shqipfolës dhe pjesëmarrës serbishtfolës ishin të kënaqur me punën e Komunës së Zveçanit. Të dy grupet përmendnin që komuna kishte ndërmarrë nisma për të ndihmuar banorët. Pjesëmarrësit shqipfolës theksonin se nuk ndiheshin të diskriminuar si komunitet jo-shumicë në këtë komunë.

Pjesëmarrësit në anketë që ishin ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me përkrahjen komunale u pyetën më tej se çfarë lloj iniciative mungonte, si dhe cila do të ishte më e dobishme për ta dhe komunitetet e tyre. Pothuajse dy të tretat e të anketuarve (61%) theksuan se komunat duhet të ofrojnë ndihmë financiare për të prekurit nga COVID-19 dhe familjet në nevojë. Një pakicë e të anketuarve përmendën shpërndarjen e pakove ushqimore e higjienike për familjet në nevojë (13%), sigurimin e qasjes më të lehtë në shërbimet mjekësore dhe ilaçe falas për të gjithë njerëzit (9%), krijimin e mundësive të punësimit (6%), shpërndarjen e maskave, dezinfektuesve e dorezave (3%), mbështetjen për bizneset dhe fermerët (2%), rritjen e nivelit të pastërtisë së hapësirave publike


(2%), marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së virusit (1%), sigurimin e vaksinave për njerëzit (1%), si dhe ofrimin e përkrahjes morale (1%).

Figura 16 Çfarë përkrahjeje mungon? Çfarë mund të bëjë më shumë komuna? (pyetje të hapura - të koduara) - sipas komunave




Të anketuarit më pas u pyetën nëse dinin për ndonjë iniciativë që komuna e tyre kishte ndërmarrë në lidhje me COVID-19. Vetëm rreth 15% e të anketuarve nga Prizreni ishin në dijeni për iniciativa të tilla, pasuar nga 21% të tyre nga Podujeva, 24% nga Rahoveci, 34% nga Zveçani, si dhe 50% nga Fushë Kosova.

Figura 17 A dini për ndonjë iniciativë që komuna juaj ka ndërmarrë në lidhje me COVID-19? - sipas komunave



Në të gjitha komunat, me përjashtim të Zveçanit, më shumë burra deklarorin të kishin njohuri për nismat që lidheshin me COVID-19 në komunat e tyre, krahasuar me gratë.

Figura 18 A dini për ndonjë iniciativë që komuna juaj ka ndërmarrë në lidhje me COVID-19? - sipas gjinisë



Respondentëve të anketës të cilët deklarorin se kishin njohuri për nismat që komunat e tyre kishin ndërmarrë iu kërkua të përmendnin nismat që kishin dëgjuar ose i dinin. Shumica e atyre që dinin për nisma të tilla në Podujevë treguan se komuna e tyre kishte shpërndarë pako ushqimore për familjet në nevojë (95%), kishte dezinfektuar hapësirat publike dhe kishte shpërndarë pako ushqimore për familjet që kishin anëtarë të infektuar me COVID-19 (43% respektivisht). Kur u pyetën se çfarë nisme kishte marrë komuna për të zvogëluar dëmet e shkaktuara nga pandemia, pjesëmarrësit e grupit të fokusit në Podujevë përmendën pakot e ndihmave sociale të shpërndara për njerëzit dhe familjet në nevojë. Ata gjithashtu përmendnin nevojën për të rritur numrin e shtretërve në spitale/qendra mjekësore gjatë pandemisë.

"(...) E di që kanë shpërndarë pako ushqimore për familjet e varfra (...) Sa i përket aspektit shëndetësor, e di se numri i shtretërve në urgjencë ishte fillimisht tre, ndërsa, si pasojë e pandemisë, u detyruan ta zgjerojnë këtë pjesë dhe aktualisht ka 11 shtretër për njerëzit e prekur nga COVID-19. Gjithashtu, është hapur një repart i plotë ku personat e infektuar trajtohen veçmas nga ata që kanë sëmundje të tjera". **Burrë, 28 vjeç, shqiptar i Kosovës, Podujevë**

"Mendoj se gjatë pandemisë, komuna ka reaguar mirë, ndërsa stafi mjekësor ishte mjaft ndihmues. Lidhur me nismat e ndërmarra nga komuna, nuk është se kam fort njohuri. Besoj se nuk kemi arsye të mos jemi të kënaqur me komunën, sepse ka ndihmuar familjet në nevojë. Megjithatë, mendoj se mund të kishin bërë më shumë". **Grua, 21 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Podujevë**

Përfaqësuesit komunalë po ashtu u pyetën për nismat që komuna kishte ndërmarrë. Përfaqësuesit e komunës së Podujevës pohuan se komuna e tyre kishte kryer efektivisht detyrat dhe obligimet e saj në plotësim të nevojave të banorëve gjatë pandemisë. Njëri nga përfaqësuesit, përgjegjës për Sektorin e Regjistrimit të Bizneseve, shpjegoi se gjatë pandemisë, numri i bizneseve të regjistruara ishte rritur, për shkak të subvencioneve për bizneset të premtuara nga institucionet qendrore. Pjesëmarrësit përmendën ekipet anti-COVID-19 të krijuara gjatë pandemisë, si një nga përpjekjet pozitive që komuna e tyre kishte bërë në koordinim me specialistët shëndetësorë. Këto ekipe kanë ndihmuar klinikat dhe banorët që të testohen, si dhe që të marrin trajtimet e duhura gjatë dhe pas infeksionit. Pjesëmarrësit po ashtu përmendnin se si komuna e tyre vazhdimisht ka dezinfektuar hapësirat publike si: spitalet, shkollat, institucionet, etj. Ata po ashtu përmendën aktivizimin e "Alo, Komuna!", një linjë telefonike, ku banorët mund të telefononin për të adresuar shqetësimet e tyre.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve nga Rahoveci deklaruan se komuna e tyre kishte shpërndarë pako ushqimore për familjet në nevojë dhe kishte dezinfektuar hapësirat publike (88% secila), pasuar nga më shumë se një e treta që deklaruan se komuna e tyre kishte siguruar pajisje mbrojtëse personale (PMP) për familjet në nevojë (38%). Pjesëmarrësit e grupit të fokusit në grupin shqipfolës ndanin mendimin se komuna e tyre nuk e kishte menaxhuar në mënyrë efikase disponueshmërinë e testeve rapide, duke shkaktuar mungesa në fillim të pandemisë.

Sipas pjesëmarrësve në fokus grupin në serbisht, ende ka struktura paralele komunale në Rahovec, si dhe komuna paralele serbe kishte ndërmarrë disa veprime për të zbutur pasojat e COVID-19, duke organizuar matjen e presionit të gjakut, duke blerë ushqime për të moshuarit, mes tjerash. Në të kundërtën, Komuna e Rahovecit në institucionet e ligjshme nuk kishte ndërmarrë iniciativë të tilla.

"[...] Menaxhimi i pandemisë nga komuna jonë ka qenë shumë i mirë, sepse kryetari i komunës ka ofruar gjithë informacionin që ka siguruar për të na informuar përmes rrjeteve sociale. Jemi informuar që ka pasur masa të marra nga institucionet qeveritare, ku komuna jonë mund të lëvizte më lirshëm, si dhe i kemi respektuar ato rregullat. Duke qenë që njihemi si fshatarë që punojnë në bujqësi [...] por në kushtet e pandemisë [...], njerëzit kanë respektuar masat. Po ashtu, komuna ka bërë sa ka mundur, por gjithmonë ka vend për përmirësim, edhe pse nuk ka qenë aq keq". **Burrë, 21 vjeç, shqiptar i Kosovës, Rahovec**

"E di që për shkak se prindërit e mi janë të moshuar, si dhe nuk i kishin pyetur asgjë, e njerëzit e moshuar kanë nevojë për ushqime, për ilaçe që shpenzohen shpejt [...] dhe as barnatoret e as shitoret nuk punonin, e kështu, duhet të intervenohej për këta njerëz, kontrolle, matje të presionit të gjakut [...] asgjë, absolutisht asgjë nuk funksiononte, e kështu, komuna kishte dështuar në çdo kuptim".
Grua, 24 vjeçe, serbe, Rahovec

Përfaqësuesit komunalë të Rahovecit theksuan dezinfektimin e vazhdueshëm të të gjitha hapësirave publike si një nga nismat kryesore për të zbutur ndikimin e COVID-19 në komunën e tyre. Ata gjithashtu vunë në dukje nisjen e Repartit të Emergjencës, udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Rahovecit. Përfaqësuesit përmendën se kufizimet e lëvizjes nuk kanë qenë aq strikte sa në qytetet e tjera, pasi Rahoveci është rajon bujqësor. Kështu, njerëzit e angazhuar në veprimtari të tilla ishin të pajisur me dokument që u mundësonte të lëviznin edhe gjatë orës policore. Përfaqësuesit gjithashtu pohuan që komuna e Rahovecit kishte liruar bizneset nga taksat komunale për vitin 2020.

Pjesa më e madhe e të anketuarve të Fushë Kosovës deklaruan se komuna e tyre kishte shpërndarë pako ushqimore për familjet në nevojë (86%), por vetëm 54% deklaruan se kishte dezinfektuar hapësirat publike. 42% e të anketuarve theksuan që komuna e tyre kishte ofruar ndihmë financiare për familjet në nevojë. Në pyetjen për nismat që kishte ndërmarrë komuna, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit përmendën se komuna kishte ofruar ndihma humanitare dhe kishte organizuar mësimin virtual për fëmijët e shkollës. Disa pjesëmarrës në diskutimet e grupeve të fokusit përmendën gjithashtu kishte siguruar edhe subvencione për banorët. Sidoqoftë, ata mendonin që shpërndarja e subvencioneve nuk kishte qenë transparente, si dhe nuk njihnin persona që i kishin marrë ato.

"E di që ka pasur shumë pako në shkollë, gjithmonë të vendosura [ose] në sallën e takimeve, [ose] në korridor ... ato donacione janë gjithmonë në hyrje të shkollës, të gjithë janë të obliguar t'i marrin (...)."
" Grua, 43 vjeçe, serbe, Fushë Kosovë

"Në lagjen ku jetoj, është krijuar një repart i urgjencës, që kishte ndihmuar me gjërat bazike, për tre muaj, por pastaj jo më. U bë punë e mirë, transparencja ka munguar, e ky ishte një problem, që shkaktonte pakënaqësi. Di për aktivitetet që janë ndërmarrë, ndërsa nuk janë të paraqitura në faqen e internetit të komunës. Mjekësia (profesionistët shëndetësorë) duhet të jetë më e informuar për mënyrat e trajtimit të pacientëve."
Grua, 27 vjeçe, rome, Fushë Kosovë

Përfaqësuesit e Komunës së Fushë Kosovës theksuan se komuna e tyre ishte përpjekur t'u shërbejë banorëve të saj dhe t'i ndihmojë ata gjatë shpërthimit të COVID-19, në të gjitha mënyrat e mundshme. Ata gjithashtu theksuan se komuna është e mbingarkuar me një numër tejet të madh të banorëve që shfrytëzojnë infrastrukturën, por buxheti ndahet në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Si pasojë, komuna nuk ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e banorëve të saj, sidomos atyre të infektuar me COVID-19. Sidoqoftë, ata ofruan shifra për pacientët e trajtuar dhe kontaktuar për çështje shëndetësore, përtej kufizimeve buxhetore. Sipas një zyrtari komunal, gjithsej 4678 pacientë morën shërbime mjekësore në vitin 2020, duke përfshirë injeksionet intravenoze dhe intramuskulare, analiza laboratorike dhe radiologjike. Gjithsej 7395 pacientë morën të njëjtat trajtime në vitin 2021.

Rreth 71% e të anketuarve në Prizren deklaruan se komuna e tyre kishte shpërndarë pako ushqimore për familjet në nevojë dhe 46% deklaruan se komunat e tyre kishin ofruar ndihmë financiare për familjet në nevojë. Rreth 18% përmendën dezinfektimin e hapësirave publike, si dhe po aq shpërndarjen e paketave ushqimore për familjet që kishin anëtarë të infektuar me COVID-19. Shumica e pjesëmarrësve nga grupet e fokusit shprehën kënaqësinë me punën e bërë nga komuna e tyre dhe theksuan nismat e komunës së Prizrenit për të ndihmuar familjet në nevojë dhe bizneset e prekura më së shumti nga pandemia. Duke marrë parasysh komentet e të gjithëve, shumica binin dakord se komuna e Prizrenit i ka adresuar nevojat e banorëve të saj në mënyrë efektive gjatë pandemisë. Disa pjesëmarrës përmendën që iniciativat morën formën e shpërndarjes së pakove ushqimore, pakove higjienike dhe shpërndarjen e 170 eurove për familje, të cilat u realizuan nga niveli qendror përmes kanaleve komunale, si dhe pakove ekonomike - për bizneset në formën e bizneseve të reja, si dhe subvencioneve, por edhe ndihmës sociale për njerëzit që kanë humbur punën.

*"Mendoj se komuna është organizuar mirë, na ka informuar, si dhe si qytetarë, kemi qenë të kujdesshëm dhe i kemi respektuar kufizimet. Për sa di unë, ka qenë mirë". **Grua, 48 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Prizren***

*"Normalisht, fillimi i pandemisë kishte të panjohura (...), por ishim pak a shumë të përgatitur nga lajmet, portalet e ndryshme; madje edhe lajmet që ishin të rreme. Por komuna e Prizrenit, besoj, ka qenë komunë e fortë dhe e suksesshme, me kryetarin që gjithashtu ka ndër marrë veprime të menjëhershme kundër COVID-19". **Grua, 23 vjeçe, rome e Kosovës, Prizren***

Përfaqësuesit e komunës së Prizrenit pohuan se kishin ndjekur të gjitha udhëzimet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Ata kishin krijuar shtabin e emergjencave me përgjegjësi për plotësimin e nevojave të banorëve, kishin ndihmuar familjet në nevojë me pako ushqimore, përmirësuar shërbimet shëndetësore dhe ishin përpjekur të ofrojnë të gjitha shërbimet e nevojshme në komunën e tyre, përfshirë oksigjeno-terapinë. Disa pjesëmarrës shpjeguan se komuna kishte aktivizuar edhe linjën telefonike "Alo, Komuna!", përmes së cilës banorët tregojnë problemet e tyre, kërkojnë ndihmë dhe komunikojnë me zyrtarët komunalë për çështje të ndryshme gjatë pandemisë. Disa shprehën kënaqshmërinë e tyre me efikasitetin e kësaj linje telefonike, ndërsa të tjerët pohuan se kjo linjë nuk ishte edhe aq efektive sa pritej.

Më se gjysma e të anketuarve që kishin dëgjuar për nisma të tilla në Zveçan thanë se komuna e tyre kishte dezinfektuar hapësirat publike (53%), 35% të tjerë thanë se kishte dezinfektuar objektet banesore, ndërsa 29% treguan se u kishte siguruar pajisje mbrojtëse familjeve që kishin anëtarë të infektuar me COVID-19. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit përmendën gjithashtu iniciativa të ngjashme, si ndihmat humanitare, ushqimore, dezinfektimi i hapësirave publike, instalimi i tuneleve të dezinfektimit dhe vaksinimet e të moshuarve.

"Sa i përket komunës, mendoj se ka bërë gjithçka që duhet të bëjë një komunë. Unë mendoj se edhe pse jemi pakicë në komunën e Zveçanit, nuk jemi diskriminuar në aspektin e mbrojtjes nga COVID, duke filluar me postierët, pastaj komuna shpesh ka ndihmuar banorët, edhe ata që kanë nevojë për ndihma humanitare, të tilla si ushqimi dhe të tjera, pastaj ka dezinfektuar shkollat që vijohen nga


*nxënësit tanë. Pastaj, komuna ka pajisur shumë institucione dhe shumë njerëz me maska, doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse. Deri në fund, kur filloi me vaksinimin e qytetarëve tanë mbi 75 vjeç. Këto janë gjërat për të cilat kam njohuri që komuna i ka bërë deri më tani. Mendoj se në bazë të kompetencave të saj si komunë - ka bërë punë të mirë. Askush nuk mund të jetë 100% i kënaqur, por ka ushtruar mundësitë dhe kapacitetet si komunë". **Burrë, 48 vjeç, shqiptar i Kosovës, Zveçan***

*"Vitin e kaluar, diku në fillim të pandemisë, në fund të marsit ose në fillim të prillit, në fakt pak pasi ishte shpallur pandemia, kufijtë ishin mbyllur dhe e di që komunat kishin zyra për të ofruar ndihmë për qytetarët. Mu aty ishte vendi për t'u dhënë para, dmth., për të porositur ilaçe nga Rashka, sepse kishin ekipin e tyre që kishte shkuar në Rashkë¹⁵ për të blerë ilaçe për njerëzit që nuk mund të shkonin atje... " **Burrë, 40 vjeç, serb i Kosovës, Zveçan***

Përfaqësuesit komunalë të Zveçanit zbuluan disa nga nismat që ata kishin ndërmarrë pas shpërthimit të COVID-19. Në fillim të pandemisë, materiali informues në lidhje me COVID-19 iu dërgua shkollave dhe institucioneve të tjera, si dhe u formuan ekipe mobile mjekësore, që kishin vizituar banorët në shtëpitë e tyre. Për më tepër, komuna kishte organizuar sigurimin e ilaçeve dhe dërgimin e tyre në shtëpitë e banorëve, ndërsa shumica e fëmijëve shkollorë në zona rurale ishin pajisur me pajisje elektronike për të qenë në gjendje të ndiqnin mësimet në internet. Për më tepër, komuna kishte organizuar vullnetarë për të ndihmuar të moshuarit të cilët nuk lejoheshin të dilnin jashtë. Ata gjithashtu pohuan se kishin përkrahur gati gjysmën e gjithë popullatës me një lloj materiali. Ata po ashtu kishin dezinfektuar hapësirat publike, kishin siguruar produkte higjienike për shkollat dhe familjet, si dhe subvencione për rreth 50 banorë në vitin 2021, si dhe 30 banorë në vitin 2020.


¹⁵ Rashka është qytet në Serbi.

Figura 19 Iniciativat e ndërmarra nga komuna në lidhje me COVID-19 - sipas komunave




Komunat që janë mbuluar me këtë hulumtim dukej se kanë arritur të mbanin qytetarët e tyre të mirinformuar lidhur me faktet dhe informacionet relevante për COVID-19. Në përgjithësi, rreth 54% e të gjithë të anketuarve nga këto komuna konsiderojnë se ata janë informuar deri diku mirë ose tejet mirë të informuar nga komunat e tyre në lidhje me pandeminë COVID-19. Një shumicë e madhe (79%) e të anketuarve në Rahovec dhe më se gjysma (56%) e të anketuarve në Prizren ishin deri diku ose shumë mirë të informuar. Një e treta ose më pak e të anketuarve në Fushë Kosovë (34%), Zveçan (30%) dhe Podujevë (23%) ishin deri diku ose shumë mirë të informuar, ndërsa rreth 60% e të anketuarve në Podujevë ishin neutralë në lidhje me informimin nga autoritetet e tyre komunale.

Figura 20 Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas komunave



Vihet re se, mesatarisht, niveli i kënaqshmërisë me *informatat e ofruara* nga komunat është më i lartë se niveli i kënaqshmërisë me *nismat e ndërmarra* nga autoritetet komunale. Në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 nënkupton 'aspak të informuar' dhe 5 do të thotë 'shumë mirë të informuar', niveli i të qenit të informuar nga komunat në lidhje me pandeminë COVID-19 ishte mesatarisht 3.3 pikë, ku përfshihen të pesë komunat. Mesatarja për Rahovecin ishte 3.7 pikë, për Prizrenin 3.5 pikë, për Zveçanin 3.3 pikë, ndërsa për Podujevën dhe Fushë Kosovën, 3.0 pikë secila.


Figura 21 Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh



Perceptimet e burrave dhe grave dallonin në kuptimin e asaj se sa të informuar ishin banorët. Në disa komuna kishte dallime të vogla, ndërsa në të tjerat shënohen dallime më domethënëse midis perceptimeve të burrave dhe grave. Për shembull, në Rahovec, 84% e grave dhe 78% e burrave ndiheshin deri diku ose shumë mirë të informuar nga komuna e tyre. Ndërsa në Prizren, 78% e burrave dhe 59% e grave ndjenin të njëjtën. Për më tepër, në Zveçan, 47% e burrave dhe 45% e


grave ndiheshin deri diku të informuar, por asnjëri nuk ndihej shumë mirë i informuar. Në Fushë Kosovë, 54% e grave dhe 35% e burrave; si dhe në Podujevë, 26% e burrave dhe 20% e grave, mendonin se ishin deri diku ose shumë mirë të informuar nga komunat e tyre në lidhje me pandeminë COVID-19.

Figura 22 Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas gjinisë



Të anketuarit që deklaruan se nuk ishin informuar aq mirë, ose aspak të informuar për pandeminë COVID-19, u pyetën për arsyet përkatëse. Pothuajse gjysma e të anketuarve pohuan se nuk ishin të informuar sa duhet ose se askush nga komunat nuk i informonte (49%), rreth 17% nuk shihnin rezultate ose e konsideronin komunën si të papërgjegjshme, ndërsa rreth 8% thanë se nuk ishin të informuar sepse askush nuk ishte interesuar t'i informojë. 4% deklaruan se nuk ishin mirë të informuar, ose aspak, për shkak të mungesës së kanaleve të informimit të përdorura nga komunat, si dhe po aq që komunat nuk i kishin kontaktuar në asnjë mënyrë. 3% të tjerë përmendën se ishin informuar përmes mediave sociale, ndërsa rreth 2% pohonin se ishin informuar vetëm për mbylljen e lokaleve, e asgjë tjetër.


Figura 23 Pse mendoni se nuk jeni informuar mirë, apo nuk jeni fare të informuar? -Sipas komunave
*vetëm ata që nuk janë informuar nga komuna e tyre në lidhje me pandeminë COVID-19



Besueshmëria e përgjithshme e informatave të dhëna nga komunat mbi pandeminë COVID-19 në pesë komunat perceptohej të ishte e kënaqshme. Përgjithësisht, 65% e të anketuarve në pesë komunat i besojnë deri diku informacionit që marrin nga komunat e tyre, ndërsa 15% e tyre i besojnë atyre shumë. Rreth 10% nuk i besonin aq shumë, ndërsa 9% nuk i besonin fare.

Të dhënat e ndara sipas komunave tregojnë se 86% e banorëve të Prizrenit, 79% e banorëve të Podujevës, 76% e banorëve të Rahovecit, 68% e banorëve të Fushë Kosovës dhe 58% e banorëve të Zveçanit i besojnë deri diku/i besojnë shumë informatave të marra nga komunat e tyre.


Figura 24 Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga komuna juaj? - sipas komunave



Ngjashëm, informatat e pranuar nga institucionet qendrore, si Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK), Ministria e Shëndetësisë dhe ministritë e tjera përkatëse të linjës besohen deri në një masë. Në total, 56% e të gjithë të anketuarve në pesë komuna i besonin deri diku, ndërsa 20% e tyre i besonin shumë. Rreth 15% nuk i besonin aq shumë, ndërsa 9% nuk i besonin fare.


Rreth 83% e të anketuarve në Prizren i besonin deri diku/i besonin shumë informatave që kishin marrë për pandeminë COVID-19 nga institucionet qendrore. 66% e banorëve të Podujevës, 80% e banorëve të Rahovecit, 81% e banorëve të Fushë Kosovës dhe 46% e banorëve të Zveçanit i besojnë deri diku/i besojnë shumë informatave të marra nga komunat e tyre. 83% e të anketuarve në Prizren, 81% e të anketuarve në Fushë Kosovë, 80% e të anketuarve në Rahovec, *deri diku i besojnë/i besojnë shumë* informatave të marra nga institucionet qendrore, ndërsa 66% e të anketuarve në Podujevë, si dhe 46% e të anketuarve në Zveçan *i besojnë deri diku/i besojnë shumë* informatave të marra nga komuna e tyre.

Figura 25 Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - sipas komunave




Në shkallë besimi nga 1 deri 4, ku 1 do të thotë "aspak", ndërsa 4 do të thotë "i besoj shumë", informatat e dhëna nga institucionet qendrore dhe komunat qëndrojnë mesatarisht në të njëjtin nivel, në të gjitha komunat. Në Prizren, të anketuarit duket se i besojnë informatave të komunës (2.94) pak më shumë se atyre të institucioneve qendrore (2.93). Në Podujevë, situata është e njëjtë, por dallimi i vetëm është se hendeku është më i madh (2.86 nga komuna, kundrejt 2.70 nga institucionet qendrore). Edhe pse besimi i përgjithshëm në Zveçan është më i ulët se në komunat e tjera, ata i besojnë informatave të marra nga komuna e tyre (2.66) më shumë sesa ato nga institucionet qendrore (2.47). Ndërsa në Rahovec, ndodh e kundërta; të anketuarit duket se i besojnë informatave të institucioneve qendrore (2.95) më shumë sesa komunës (2.76). Të anketuarit në Fushë Kosovë kishin të njëjtat bindje, por hendeku është më i madh (2.79 komuna kundrejt 3.18 institucionet qendrore).

Figura 26 Besimi i informatave të dhëna nga Komuna kundrejt atyre nga institucionet qendrore - në shkallë prej 4 pikave, sipas komunave




Besimi në informatat e institucioneve qendrore është i ngjashëm për burrat dhe gratë, ku 52% e grave dhe 49% e burrave i besojnë deri diku, ndërsa 25% e burrave dhe 22% e grave i besojnë shumë.

Figura 27 Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga: institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - në përgjithësi, sipas gjinisë



Grupmosha të ndryshme shfaqin nivele të ndryshme besimi ndaj informatave nga institucionet qendrore. Pjesa më e lartë e pensionistëve (65+ vjeç), banorëve të moshuar (55-64 vjeç) dhe atyre të mileniumit (25-34 vjeç) i besojnë deri diku ose i besojnë shumë informatave (82%, 77% dhe 77%, respektivisht) ndërsa 76% e moshave të mesme (45-54 vjeç) dhe 72% e të rinjve (18-24 vjeç) i besojnë deri diku, ose i besojnë shumë.


Figura 28 Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga: institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - në përgjithësi, sipas moshave



Kur pyeten se si i marrin informatat në lidhje me çështjet, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunat e tyre lidhur me COVID-19, 81% e të anketuarve pohuan t’i kenë marrë nga njoftimet e televizioneve lokale ose ato kombëtare, 57% përdorin Facebook-un, 39% mbështeten në familje dhe miq, 12 % në Instagram, 10% në faqen zyrtare të komunës, ndërsa një pakicë e të anketuarve kanë parë edhe posterat informues në të gjithë qytetin (4%), kanë marrë telefonata (2%) dhe mesazhe me tekst (2%). Shumë pak përdorin YouTube (2%) dhe LinkedIn (0.2%) për të marrë informatat e tilla.


Tre burimet kryesore të informimit në të gjitha komunat ishin njoftimet nga televizionet lokale ose të Kosovës, Facebook-u, si dhe familja e miqtë. Sidoqoftë, dallimet në renditjen e familjes dhe miqve si burim informimi janë të dukshme. Për shembull, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve në Podujevë mbështeten në familjet dhe miqtë e tyre (79%) si burim të parë të informimit, ndërsa më shumë se gjysma e të anketuarve në Zveçan (54%) i konsiderojnë si burimin e tyre të dytë të informimit. Gati gjysma e të anketuarve në Rahovec (46%), më shumë se një e treta e atyre në Fushë Kosovë (38%), si dhe më pak se një e pesta në Prizren (15%) raportuan të njëjtën gjë.

Figura 29 Si i merni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - sipas komunave




Ekzistojnë disa dallime sesi burrat dhe gratë marrin informatat në lidhje me situatën, masat dhe përkrahjen e lidhur me COVID-19, e të ofruar në komunat e tyre. Më shumë gra (84%) sesa burra (78%) i marrin nga njoftimet e televizioneve lokale apo kosovare si burim kryesor të informacionit. Më shumë burra përdorin Facebook-un (66%) dhe mbështeten te familja dhe miqtë (43%) si burim sekondar dhe terciar i informimit, sesa gratë (48%, respektivisht 35%). Gratë (12%) përdorin Instagram-in pak më shumë se burrat (11%), ndërsa burrat (13%) përdorin faqet zyrtare komunale të internetit më shumë se gratë (7%), por edhe kanë hasur në postera në gjithë qytetin (7%) më shpesh sesa gratë (2%).

Figura 30 Si i merrni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - në përgjithësi, sipas gjinisë



Më shumë të anketuar nga gjeneratat e reja përdorin Facebook-un dhe Instagram-in për të marrë informata në lidhje me situatën, masat dhe përkrahjen që ofrohen në komunën e tyre në lidhje me COVID-19. Sidoqoftë, ndonjëherë brezat e rinj mbështeten më shumë tek njoftimet e televizioneve lokale ose kombëtare, ose në faqet zyrtare komunale, sesa brezat më të moshuar. Konkretisht, vihet re se grupmoshat 18-24 dhe 25-34 vjeç përdorin Facebook-un si burimin e tyre kryesor të informimit (83%, respektivisht 77%), ndërsa njoftimet e televizioneve lokale ose kosovare si burim dytësor. Ndërkohë, të gjitha grupmoshat e tjera kanë njoftimet e televizioneve lokale ose kosovare si burim kryesor të informimit, si dhe Facebook-in si burim të dytë, përveç banorëve të moshuar/pensionistëve, për të cilët familja dhe miqtë janë burimi i dytë.


Figura 31 Si i merni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? – sipas moshave



Është e rëndësishme të vlerësohet sesi kosovarët e etnive të ndryshme informohen për çështjet që lidhen me COVID-19 në komunat e tyre. Shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës mbështeten kryesisht në njoftimet e televizioneve lokale ose kosovare, edhe pse në shkallë të ndryshme (82%, respektivisht 62%). Facebook-u vjen i dyti për shqiptarët e Kosovës (57%), ndërsa familja dhe miqtë për serbët e Kosovës (55%). Familja dhe miqtë janë të tretët për shqiptarët e Kosovës (39%), ndërsa Facebook-u është i treti për serbët e Kosovës (52%).

Vlen po ashtu të përmendet që një pjesë shumë më e madhe e serbëve të Kosovës (33%), krahasuar me shqiptarët e Kosovës (10%), përdorin Instagram-in për të marrë informata mbi COVID-19. Për më tepër, më se një në dhjetë serbë të Kosovës deklarojnë se kanë pasur telefonata, ndërsa gati një në dhjetë sosh ka marrë mesazhe teksti (9%) ose kanë përdorur YouTube (9%), krahasuar me shqiptarët e Kosovës (1%, 2%, 1% respektivisht). Diskutimi i përgjithshëm i grupit të fokusit i konfirmoi këto gjetje, ku shumica përmendte "mediat" në përgjithësi si burimin e tyre të informimit, TV-të dhe mediat sociale në veçanti.

Figura 32 Si i merni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - sipas etnive



*Etnitë e tjera nuk janë paraqitur në grafik si pasojë e numrit të ulët të rasteve

Përveç pyetjes për burimet kryesore të informimit, të anketuarit u pyetën nëse informatat që u viheshin në dispozicion ishte marrë në kohën e duhur. Në përgjithësi, 94% e atyre që shfrytëzohnin faqet zyrtare komunale, 86% e atyre që përdornin Facebook-un dhe Instagram-in, 83% e atyre që kishin njoftimet e televizioneve lokale ose të Kosovës, si dhe 79% e atyre që mbështeteshin tek familja dhe miqtë, perceptonin që informatat që kishin marrë për temën lidhur me komunën e tyre ishte me kohë.

Tabela 1 E keni marrë këtë informata në kohën e duhur ose shumë vonë? - bazuar në kanalet e komunikimit që janë shfrytëzuar


	Njoftimet televizioneve lokale ose kombëtare N=408	Facebook N=300	Familja dhe miqtë N=212	Instagram N=58	Faqja zyrtare e komunës N=45
Po	83%	86%	79%	86%	94%
Jo	15%	11%	17%	13%	6%
Nuk e di	2%	2%	4%	2%	1%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

*Rezultatet për mënyrat e tjera të informimit janë vetëm indikative, prandaj nuk janë paraqitur në tabelë

Shumica e të gjithë të anketuarve (89%) kishin perceptimin se informatat lidhur me COVID-19, të ofruara nga komuna e tyre, ishin të lehta për t'u kuptuar, që do të thotë, gjuha ishte e qartë dhe jo teknike, pamjet ishin të përshtatshme, mesazhet ishin koncize dhe kështu me radhë. Të ndarë sipas komunave, 94% e të anketuarve në Prizren, 91% e të anketuarve në Rahovec, 85% e të anketuarve


në Podujevë, si dhe 81% e të anketuarve në Fushë Kosovë pohuan se informatat lidhur me COVID-19 ishin të lehta për tu kuptuar. Sidoqoftë, vetëm 60% e të anketuarve në Zveçan mendonin kështu, ndërsa 26% e tyre pohuan se nuk e dinë nëse informacioni ishte i lehtë për t'u kuptuar.

Figura 33 Sa të lehta për t'u kuptuar ishin informatat lidhur me COVID-19 të ofruara nga komuna juaj (gjuhë e qartë jo-tekniqe, fotografi/video të përdorura sipas nevojës, mesazhe koncize, etj.)? - sipas komunave



Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse informatat lidhur me COVID-19 të ofruara nga komunat e tyre ishin në gjuhën e tyre amtare, ku 94% e tyre thanë po. Kur krahasohet midis etnive, 95% të shqiptarëve të Kosovës, por vetëm 74% e serbëve të Kosovës, thonë që kanë marrë informata në gjuhën e tyre amtare.


Figura 34 A ofrohen informatat lidhur me COVID-19 nga komuna juaj në gjuhën tuaj amtare? - sipas etnive



*Rezultatet për boshnjakët e Kosovës dhe turqit e Kosovës janë vetëm indikative, kështu nuk janë paraqitur në grafik

Kur krahasohen sipas komunave, 99% e të anketuarve në Fushë Kosovë, 95% e të anketuarve në Prizren, 92% e të anketuarve në Podujevë, 92% e të anketuarve në Rahovec, si dhe 84% e të anketuarve në Zveçan pohuan se informatat e ofruara nga komunat e tyre ishin në gjuhën e tyre amtare.

Figura 35 A ofrohen informatat lidhur me COVID-19 nga komuna juaj në gjuhën tuaj amtare? - sipas komunave



Me një pyetje të hapur për përgjigje, të anketuarve iu kërkua të renditin kanalet e tjera të komunikimit që komunat duhet të përdorin për të ofruara informata lidhur me COVID-19 për të arritur më mirë tek ata. Të anketuarit përmendën katër burime kryesore, përfshirë reklamat televizive dhe programet posaçërisht për COVID-19, mediat sociale si Facebook-u dhe Instagram-i, mesazhet me tekst, si dhe vizitat në fshatra dhe komuna, si dhe/ose dëgjime publike. Shumica e të anketuarve në Podujevë (71%) preferuan më shumë programe për COVID-19 në TV. 43% e të anketuarve në Rahovec kërkonin më shumë programe në TV, ndërsa 28% kërkonin përdorim aktiv të mediave sociale. Në masë më të vogël - por ndërlidhur me të njëjtat kanale komunikimi, të anketuarit në Fushë Kosovë preferuan përdorimin e mediave sociale (21%) dhe përmbajtjes televizive (20%) - në vend të kanaleve të tjera, ndërsa një pjesë e konsiderueshme po ashtu përmendnin faqen zyrtare komunale (19%) si opsion i preferuar. Shifra më të larta të të anketuarve në Prizren dhe Zveçan mendonin se nuk ka nevojë për forma të tjera të komunikimit. Sidoqoftë, rreth një në pesë të anketuar (18%) në Prizren përmendën se një kanal tjetër kyç i komunikimit duhet të jetë me mesazhe tekstuale. Një në pesë të anketuar në Zveçan (20%) preferuan përdorimin më aktiv të mediave sociale.

Vlen të përmendet se ka të anketuar që duan më shumë kanale komunikimi në gjuhët e tyre, si boshnjake dhe turke. Më pak të anketuar përmendën telefonatat, radion dhe emailat si kanale komunikimi, përmes të cilave do të arriheshin më mirë nga komunat e tyre.

Tabela 2 Cilat kanale të tjera komunikimi duhet të përdorë komuna për të ofruar informata lidhur me COVID-19 në mënyrë që t'ju arrijë më mirë? - pyetje të hapura, sipas komunave

	Përgjithësisht					
	ht (ponderuar)	Zveçan (N=50)	Fushë Kosovë (N=100)	Podujevë (N = 100)	Prizren (N=150)	Rahovec (N=100)
TV (më shumë reklama, programe, etj.)	30.4%	12%	20%	71%	10%	43%
Mediat sociale (Facebook, Instagram)	11.9%	20%	21%	11%	5%	28%
SMS	9.8%	8%	3%	2%	18%	1%
Nuk ka nevojë për medime tjera informimi /jam i/e kënaqur	9.5%	30%	8%		8%	24%
Vizita në fshatra dhe komuna / Takime	5.9%	6%	12%	3%	7%	4%

publike

Fletëpalosje, posterë e reklama	4.3%	2%	3%	4%	6%	1%
Faqja zyrtare (komunat dhe institucionet përkatëse)	3.2%	6%	19%	1%	2%	
Internet	2.4%		5%	6%	1%	1%
Telefon / Telefonata	2%	2%	12%	2%	1%	
Radio	1.3%	4%	1%	3%	1%	
Kanalet në boshnjakisht	1%		1%		2%	
Gazeta, lajme elektronike	1%	2%		2%		3%
Familja, të afërmit dhe miqtë	0.3%				1%	
Kanale në turqisht	0,3%				1%	
Email	0.2%	2%	1%			
Tjera	0.3%		1%	1%		
Na / Asgjë	30.3%	16%	19%	11%	46%	22%
Gjithsej	<i>*Vetëm indikative, për shkak të numrit të ulët të rasteve</i>	100%	100%	100%	100%	100%

Pyetjet mbi shpërndarjen e informacionit u shtjelluan edhe në diskutimet e grupeve të fokusit. Pjesëmarrësit shqipfolës në grupin e fokusit në Rahovecit ishin të kënaqur me mënyrën se si komuna e Rahovecit i kishte informuar banorët e saj. Disa pjesëmarrës përmendën se aktivitetet dhe vendimet e ndërmarra nga komuna e tyre janë paraqitur në faqen zyrtare të komunës. Shumica e pjesëmarrësve theksuan se kishin marrë informata edhe nga radio-stacioni i tyre lokal, portalet e lajmeve, si dhe theksonin të ishin të kënaqur me mënyrën se si komuna e tyre kishte komunikuar me ta. Megjithatë, ata nga grupi serbishtfolës u shprehën se komuna rrallë i kishte kontaktuar, si dhe komuniteti serb nuk është në dijeni të shërbimeve komunale të ofruara për ta, si dhe në përgjithësi nuk presin ndonjë mbështetje nga komuna. Sipas tyre, serbët e Kosovës në komunën e Rahovecit janë kryesisht banorë të moshuar të cilët nuk përdorin internet dhe rrjete sociale. Kështu, ata kryesisht ishin informuar përmes fëmijëve të tyre ose të njohurve të tjerë që kishin marrë informata në internet ose përmes kanaleve televizive në gjuhën shqipe, si dhe e kishin ndarë informatën gojarisht.

Kur u pyetën se si komuna i kishte informuar banorët e saj për çështjet dhe masat e marra për situatën me COVID-19, zyrtarët komunalë dhe asamblistët e komunës së Rahovecit shpjeguan se i kishin përdorur vazhdimisht mediat sociale si mjet për të informuar të tjerët dhe për t'i mbajtur të njoftuar. Ata gjithashtu përmendën bashkëpunimin me qendrat mjekësore për të informuar banorët e tyre në baza ditore për situatën, numrin e të infektuarve dhe nismat në lidhje me shërbimet shëndetësore dhe kujdesin social.

Pjesëmarrësit nga grupi i fokusit në gjuhën shqipe dhe grupi në serbisht në Prizren kishin përvoja të ndryshme në lidhje me informatat e pranura nga komuna. Për të parin, shumica e pjesëmarrësve pohuan se në shumicën e rasteve ishin informuar nga mediat lokale dhe rajonale, si dhe rrjetet e tjera sociale për ngjarjet e fundit, numrin e rasteve të infektuara dhe të gjitha masat që ishin marrë nga institucionet qendrore në komunën e tyre. Sipas tyre, informacioni i dhënë ishte i mjaftueshëm, në kohë dhe i drejtë. Ky i fundit ishte i vetëdijshëm se informatat ishin shpërndarë dhe mendonin se ishin të besueshme, por përmendën po ashtu se kishte probleme në aspektin e gjuhës së përdorur; posterat dhe reklammat ishin vetëm në gjuhën shqipe.

Disa zyrtarë komunalë dhe asamblistë besonin se Komuna e Prizrenit ka arritur t'i informojë mirë banorët e saj, ndërsa të tjerët pohonin se ka vend për përmirësim. Përfaqësuesit shpjeguan se masat e marra nga komuna e tyre janë shpërndarë përmes mediave të Kosovës dhe mediave sociale. Disa përmendën se njoftimet janë postuar në faqen zyrtare të komunës për njoftimin me kohë për ndryshime e masa. Megjithatë, disa nuk pajtoheshin që kanalet e përdorura për të informuar të tjerët kanë qenë aq të kënaqshëm e as efikasë.

Pjesëmarrësit e grupit të fokusit në gjuhën shqipe të Fushë Kosovës shprehën pakënaqësi me mënyrën se si komuna e Fushë Kosovës i kishte informuar banorët e saj. Pjesëmarrësit mendonin se informacioni i dhënë në faqen zyrtare të komunës shpesh nuk ishte aq informues, si dhe disa nga informatat në lidhje me aktivitetet ose vendimet e marra mungonin plotësisht. Shumica e pjesëmarrësve deklaroi se i kanë marrë të gjitha informatat nga mediat lokale dhe rajonale, si dhe mediat sociale. Pjesëmarrësit serbisht-folës përmendën se ishin informuar përmes mediave tradicionale ose rrjeteve sociale. Komuna e Fushë Kosovës kishte shfrytëzuar një dyqan në Uglarë si tabelë njoftimesh, për të informuar banorët për ngjarjet ose lajmet në lidhje me komunën e tyre. Për më tepër, pjesëmarrësit pohonin se shpesh, informatat në lidhje me masat e komunave për të frenuar përhapjen e COVID-19 nuk ishin shpërndarë në kohën e duhur. Sidoqoftë, shumica e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit mendonin se informacioni nga komuna është i besueshëm.

Shumica e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të Komunës së Fushë Kosovës kanë theksuar se edhe pse komuna e tyre ka ndërmarrë shumë masa që kanë për qëllim trajtimin e efekteve të pandemisë, ata nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për informimin e banorëve të tyre përmes kanaleve të ndryshme. Ata po ashtu u shprehën vetë-kritikë për mungesën e transparencës në proces. Megjithatë, shumica e tyre pohuan se njerëzit që jetojnë në Fushë Kosovë janë informuar përmes mediave kombëtare, të cilat kanë mbuluar ngjarjet në të gjithë Kosovën dhe rajonin .

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në gjuhën shqipe në Zveçan përmendën zyrën për komunikim midis fshatrave në Lipë, ku banojnë shumica e shqiptarëve të Kosovës, që kishte rritur qasshmërinë në informata që i përçoheshin fshatrave. Ata po ashtu besonin se informatat ishin të duhura dhe me kohë. Megjithatë, disa pjesëmarrës shqiptarë të Kosovës kanë shpjeguar se nuk marrin informata ose shërbime drejtpërdrejt nga komuna, por nga një zyrë ndërlidhëse - përkatësisht Zyra për Komunitete - e krijuar nga komuna dhe e vendosur në fshatin e populluar me shqiptarë të Kosovës, Lipë.¹⁶ Kjo kishte mundësuar që informatat të arrinin tek banorët në kohën e duhur.

Edhe pse pjesëmarrësit që flisnin serbisht besonin se ishin mjaft mirë të informuar, ata mendonin që komuna nuk i kishte informuar banorët për iniciativat. Po ashtu, informatat që kishin marrë ishin ofruar ose përmes mediave sociale ose TV-së, si dhe mendonin që informacioni ishte i besueshëm.

Në grupin e fokusit të zyrtarëve komunalë dhe asamblistëve të kuvendit, pjesëmarrësit pohonin se njerëzit ishin informuar vetëm përmes televizorit, radios dhe faqes komunale të internetit, për shkak të ndalimit të lëvizjes. Informatat ishin ndarë edhe në gjuhën shqipe, ndërsa materialet promicionale në lidhje me parandalimin ishin vendosur në vende të dukshme; ishte siguruar edhe

¹⁶ Kjo zyrë shërben si zyrë e posaçme për shqiptarët e Kosovës që janë banorë të komunës. Brenda Zyrës për Komunitete, ka disa sektorë të posaçëm në të cilët shqiptarët e Kosovës nga fshatrat e Zveçanit mund të marrin informata në lidhje me masat, vendimet, veprimet dhe aktivitetet e ndryshme të ndërmarrura nga komuna e tyre dhe shërbimet e nevojshme në gjuhën shqipe. Njerëzit po ashtu mund t'i adresojnë shqetësimet dhe problemet përmes kësaj zyre në komunën e Zveçanit. Sidoqoftë, faqja zyrtare e komunës së Zveçanit nuk përmban asnjë informatë; por, ekziston një faqe paralele, e cila ka informata në gjuhën serbe dhe shqipe. Shih faqen paralele këtu: <http://www.ezvecan.com/>

një billboard. Ata po ashtu përmendën se komuna është e gatshme të përmirësohet dhe të trajtojë mangësitë.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit në Podujevë thanë se ishin informuar kryesisht përmes mediave rajonale, lokale dhe elektronike. Pjesëmarrësit gjithashtu vunë në dukje se besimi në burimet e informatave dallon ndjeshëm, varësisht nga individi dhe qasja e tij/saj në ato burime. Gjatë diskutimit, u theksua se të moshuarit, për shembull, kanë më shumë vështirësi në të kuptuarit e informatave të bazuara në teknologji, krahasuar me brezat e rinj.

Në grupin e fokusit të zyrtarëve komunalë dhe anëtarëve të asamblesë, pjesëmarrësit pohuan se komuna e tyre kishte shfrytëzuar kanale të ndryshme për të informuar banorët e saj - kryesisht televizionet lokale dhe platformat e mediave sociale. Aktivitetet, nismat dhe informacionet mbi kufizimet e lëvizjes dhe dëgjimet publike ishin postuar edhe në faqen zyrtare të internetit të komunës së Podujevës, pasi kryetari i ri e kishte marrë mandatin¹⁷.

Kënaqshmëria e njerëzve me angazhimin e tyre nga komunat

Moduli i dytë i anketës trajtoi njohuritë dhe kënaqshmërinë e të anketuarve mbi kanalet e angazhimit të njerëzve që komunat kanë përdorur gjatë pandemisë (gjatë një periudhe njëvjeçare), siç janë dëgjimet publike. Hulumtimet indikative¹⁸ tregojnë që njerëzit në Kosovë nuk marrin pjesë aq shumë në dëgjimet publike komunale - të cilat janë mjet i domosdoshëm dhe dispozitë ligjore, për të siguruar që planifikimi buxhetor i aktiviteteve të komunës është në përputhje me pritjet e palëve të ndryshme të interesit, siç janë qytetarët, bizneset dhe subjektet tjera që jetojnë dhe veprojnë në komunë.

Në përgjithësi, gjetjet nga të dhënat e këtij moduli tregojnë që angazhimi i njerëzve në komuna qëndronte në nivele të ulëta, si dhe tejet i rrallë tek të anketuarit. Shumica e të anketuarve pohonin që komunat e tyre nuk kishin mbajtur asnjë dëgjim publik para ose pas pandemisë. Shumë pranonin se nuk kishin njohuri nëse kishte pasur dëgjime të tilla; kjo ishte sidomos e dukshme tek banorët e Zveçanit dhe Rahovecit. Vetëm 33 të anketuar gjithsej deklaruan se komunat e tyre kishin mbajtur dëgjime publike që nga përhapja e virusit, ndërsa vetëm katër të anketuar kishin marrë pjesë në to. Informatat e dëgjimeve publike ishin ndarë kryesisht përmes mediave sociale.

Sidoqoftë, diskutimet në grupet e fokusit zbuluan se shumica e pjesëmarrësve nuk ndjeheshin aq mirë të informuar mbi atë se kur dhe ku ishin mbajtur dëgjimet, ose nuk dinin fare që ishin mbajtur. Serbët e Kosovës ndiheshin posaçërisht dobët të informuar, ndërsa një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve pranuan po ashtu se ka mungesë interesimi për aktivitetet e angazhimit qytetar. Këto gjetje cilësore mund të sugjerojnë që mungesa e informatave relevante për dëgjimet publike mund të ketë kontribuar në këtë panjohuri për to. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit që kishin marrë pjesë në dëgjime theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete të tilla si qytetarë aktivë. Këta gjithashtu theksuan se për shkak të pandemisë, disa nga dëgjimet ishin zhvendosur në platforma virtuale, duke e bërë edhe më vështirë për brezat e vjetër, që janë më pak të aftë në përdorimin e teknologjisë, që të hyjnë e të marrin pjesë.

¹⁷ Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës në Podujevë u mbajtën më 29 nëntor 2020. Kryetari i zgjedhur ishte Shpejtim Bulliqi, kandidat nga Lëvizja Vetëvendosje. Për më shumë informata, ju lutemi shihni: <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/12/1.-Rezultatet-sipas-komunave.pdf>

¹⁸ Instituti Demokratik i Kosovës "Procesi i hartimit të Buxheteve Komunale në Kosovë", 2019. <<https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/02/Municipal-Budget-Development-Process-in-Kosovo-ENG-me-ISBN.pdf>>


Në përgjithësi, gjetjet e të dhënave të anketës dhe të grupeve të fokusit sugjerojnë se ka vend për përmirësim kur bëhet fjalë për komunikimin dhe ndërveprimin midis komunës dhe banorëve. Disa nga përfaqësuesit që morën pjesë në grupe të fokusit theksuan se ka nevojë për më shumë dëgjime publike dhe aktivitete të ngjashme, për të rritur këmbimin e informatave e ideve midis komunave dhe qytetarëve të tyre. Gjetjet e anketës e theksuan edhe më shumë këtë çështje, ku pothuajse të gjithë të anketuarit deklarorin që komuna e tyre nuk i kishte kontaktuar në ndonjë mënyrë tjetër, por as banorët nuk kishin bërë përpjekje për t'iu drejtuar atyre.

Gjetjet e këtij moduli zbuluan më tej se banorët mendonin se komunat e tyre duhet t'i jepnin përparësi sigurimit të ndihmës financiare për familjet në nevojë dhe ato të prekura nga COVID-19, ndërsa disa përmendën nevojën për subvencionim të bizneseve ose masat më të rrepta parandaluese kundër COVID-19 si prioritete kryesore.

Kur u pyetën nëse komunat e tyre kishin mbajtur dëgjime publike **para përhapjes së COVID-19**, 65% e të gjithë të anketuarve që përfaqësonin pesë komunat thanë që jo, rreth 29% e të anketuarve pohuan se nuk e dinin, por vetëm 7% thanë që po.

Më shumë se gjysma e të anketuarve në Zveçan (52%) nuk e dinin nëse në komunën e tyre ishin mbajtur dëgjime publike para COVID-19, rreth një e treta e tyre (32%) pohuan se dëgjimet publike ishin mbajtur, ndërsa 16% pohonin të kundërtën. Më shumë se gjysma e të anketuarve në Rahovec (56%) nuk e dinin nëse komuna e tyre kishte mbajtur dëgjime publike, ndërsa 26% e tyre thanë se komuna nuk kishte mbajtur të tillë, e 18% thanë se po. Rreth dy të tretat e të anketuarve në Fushë Kosovë (64%) thanë se komuna e tyre nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik para shpërthimit të COVID-19, 32% nuk e dinin, ndërsa 4% pohuan se po. Shumica e të anketuarve në Podujevë (94%) pohuan se nuk kishte pasur dëgjime publike të mbajtura në komunën e tyre para COVID-19, 4% pohuan se kishte pasur, ndërsa 2% nuk kishin informata në këtë drejtim. Në fund, rreth dy të tretat e të anketuarve në Prizren (57%) gjithashtu pohuan se komuna e tyre nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik para COVID-19, 31% nuk e dinin, ndërsa 3% thanë po.

Figura 36 A ka mbajtur komuna juaj ndonjë dëgjim publik para shpërthimit të COVID-19 (para marsit 2020)? - sipas komunave



Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, secila komunë mban dëgjime publike të paktën dy herë në vit, ku secili person apo organizatë që banon dhe vepron në komunën përkatëse mund të marrë pjesë. Njëri nga dëgjimet duhet të mbahet në gjysmën e parë të vitit. Në takime, përfaqësuesit e komunës i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, ndërsa pjesëmarrësit mund të ngrenë çështje të ndryshme dhe të paraqesin propozime.

Në vitin 2020, Prizreni, Podujeva dhe Rahoveci kanë organizuar dy takime publike me banorët, ndërsa Zveçani dhe Fushë Kosova nuk kanë mbajtur ndonjë dëgjim publik.¹⁹


Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse komunat e tyre kishin mbajtur dëgjime publike **pas shpërthimit** të COVID-19. Ngjashëm me rezultatet paraprake, 66% e të gjithë të anketuarve që përfaqësonin pesë komunat thanë jo, rreth 29% e të anketuarve pohuan se nuk e dinë, si dhe vetëm 4% thanë që po.

Krahasuar me sa më sipër, edhe më shumë të anketuar në Zveçan (72%) nuk e dinin nëse komuna e tyre kishte mbajtur dëgjim publik pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, 18% pohuan se ishin mbajtur, ndërsa 8% pohuan se nuk kishte mbajtur. Ngjashëm, 58% e të anketuarve në Rahovec nuk e dinin nëse komuna e tyre kishte mbajtur dëgjime publike, ndërsa 30% e tyre thanë se komuna nuk kishte mbajtur të tillë, e 12% thanë se po. 61% e të anketuarve në Fushë Kosovë (64%) thanë se komuna e tyre nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, 31% nuk e dinin, ndërsa 8% pohuan se po. Përsëri, një pjesë e madhe e të anketuarve në Podujevë (92%) pohuan se nuk kishte pasur dëgjime publike të mbajtura në komunën e tyre pas shpërthimit të COVID-19, 4% pohuan se ishin mbajtur, ndërsa 3% nuk e dinin. Një pjesë edhe më e madhe e të

¹⁹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i funksionimit të komunave në vitin 2020. <<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/04/1.-Raporti-i-funksionimit-te-komunave-2020-FINALE-1.pdf>>


anketuarve në Prizren (71%) pohuan se komuna e tyre nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik pas përhapjes së COVID-19, 29% nuk e dinin, ndërsa 1% thanë që po.

Figura 37 A ka mbajtur komuna juaj ndonjë dëgjim publik pas shpërthimit të COVID-19 (që nga marsi 2020 e deri më tash)? - sipas komunave



Vetëm disa të anketuar (33 nga 500 gjithsej) pohuan se komuna e tyre ka mbajtur dëgjime publike që nga fillimi i pandemisë COVID-19. Këta të anketuar më pas u pyetën se si ishin informuar në lidhje me dëgjimet publike, nëse e dinin sa të tillë ishin mbajtur dhe si ishin organizuar. Gjithsej 60% e të anketuarve pohuan se ishin informuar përmes Facebook-ut, 27% përmes njoftimeve televizive lokale ose kombëtare, 23% përmes faqeve zyrtare të komunave, 14% përmes përfaqësuesit të fshatit, 11% përmes telefonatave dhe 5% përmes mesazheve tekstuale. Rreth 72% e të anketuarve thanë se kishte 0-1 dëgjime publike të mbajtura në komunën e tyre, 24% thanë 2-3 dëgjime publike, 2% thanë 4-6, ndërsa 2% thanë se ishin mbajtur më shumë se 6 dëgjime publike. Për më tepër, 58% e të anketuarve thanë se dëgjimet publike u organizuan në ambiente fizike, 23% thanë se u organizuan në internet, 15% thanë se ishin përzierje e të dyja formave, ndërsa 4% nuk e dinin.


Figura 38 Si jeni informuar për dëgjimet publike pas shpërthimit të COVID-19? **Figura 39** A e dini sa dëgjime publike janë mbajtur pas shpërthimit të COVID-19? **Figura 40** Si janë organizuar dëgjimet publike pas shpërthimit të COVID-19?



*vetëm rastet kur të anketuarit pohuan se komuna ka mbajtur dëgjim publik pas shpërthimit të COVID-19, N=33

Të anketuarit që ishin informuar për dëgjimet publike u pyetën nëse kishin marrë pjesë në ndonjë prej tyre, cilat tema ishin trajtuar dhe nëse kishin shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me pandeminë COVID-19. Vetëm katër nga 33 persona që kishin dëgjuar për dëgjime publike thanë se kanë marrë pjesë në ndonjë prej tyre. Temat që ishin trajtuar përfshinin çështje që lidhen me pandeminë, furnizimin me ujë, ndriçimin e rrugëve dhe ndërtimin e mirëmbajtjen e rrugëve.

Figura 41 A keni marrë pjesë në ndonjë nga dëgjimet publike të mbajtura pas shpërthimit të COVID-19? *vetëm rastet kur të anketuarit pohuan se komuna ka mbajtur dëgjim publik pas shpërthimit të COVID-19



Tema e angazhimit të njerëzve në çështje komunale u diskutua edhe në grupet e fokusit për të marrë pasqyrë më të qartë të nivelit të angazhimit, si dhe të faktorëve pengues.

Shqipfolësit rrallë kishin marrë pjesë në dëgjimet publike në Prizren. Ajo që u dallua në diskutim ishte se nga gjashtë pjesëmarrës, vetëm dy pjesëmarrës që i përkasin komunitetit rom deklaruan se kishin marrë pjesë në dëgjime publike si përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Pjesa tjetër e pjesëmarrësve shpjeguan se ose nuk ishin të informuar, nuk kishin kohë për të marrë pjesë ose nuk ndien dëshirën për t'u përfshirë në aktivitete të tilla vendimmarrëse, përmes dëgjimeve publike të mbajtura nga komuna e tyre.

*“As unë nuk kam marrë pjesë. Kemi dalë në punë, ktheheshim të lodhur, duhej të merreshim me familjet tona - kështu që nuk kemi marrë pjesë”. **Grua, 48 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Prizren***

Grupi serbishtfolës në Prizren në përgjithësi nuk ishte angazhuar as në dëgjime publike, përveç nëse përfaqësonin OSHC-të ose persona të tjerë juridikë. Ka pasur dëgjime publike para pandemisë, ndërsa ishin shpallur përmes faqes së internetit të komunës. Dëgjimet janë organizuar përmes platformës Zoom gjatë pandemisë; megjithatë, shumica e banorëve nuk ishin në dijeni për këtë. Dy serbët e Kosovës pjesëmarrës në grup megjithatë, kurrë nuk kishin dëgjuar për dëgjime publike, as nuk ishin informuar për to.

*“(…) dëgjimet publike kanë qenë në dispozicion edhe në internet, në Zoom, kështu që ka qenë e hapur për ata që duan të merrnin pjesë. Kam ndjekur një debat publik dy javë më parë, pasi që kemi pasur kërkesë për një qendër rinore, që nuk e kemi marrë ende”. **Grua, 19 vjeçe, boshnjake e Kosovës, Prizren***

Përfaqësuesit komunalë të Prizrenit pohuan se gjatë pandemisë, komuna kishte organizuar katër dëgjime publike; shumica e tyre kishin të bënë me buxhetimin, si dhe kishte informuar banorët e tyre përmes faqes së saj zyrtare. Xhirimi i seancës u vendos në faqe të internetit më vonë, për hir të transparencës. Pjesëmarrësit u pajtuan se dëgjimet publike janë dëshmuar të jenë efektive, si dhe kanë vepruar si kanal përmes të cilit kërkesat e banorëve janë grumbulluar e adresuar më vonë nga komunat. Përfaqësuesit komunalë ia atribuon shkallën e ulët të pjesëmarrjes së banorëve kufizimeve të vendosura ndaj lëvizjes dhe tubimeve. Për më tepër, ata po ashtu besonin se një numër i konsiderueshëm i njerëzve nuk janë të njohur me platformat virtuale dhe mediat sociale, veçanërisht brezat e vjetër.

Grupi i pjesëmarrësve shqipfolës në Rahovec pohuan se kanë dëgjuar për dëgjime publike të organizuara para pandemisë. Disa prej tyre thanë se nuk ishin të informuar për ndonjë dëgjim publik që nga shpërthimi i COVID-19, ndërsa të tjerët thanë se dëgjimi është organizuar në internet gjatë kësaj periudhe.

*“(…) Sa i përket dëgjimeve publike, janë organizuar në internet, me sa di unë, por nuk është se kanë pasur shumë ndikim. Banorët janë kontaktuar më shumë përmes rrjeteve sociale”. **Burrë, 21 vjeç, shqiptar i Kosovës, Rahovec***

Ata nga grupi serbishtfolës në Rahovec pohuan se nuk ishte mbajtur ndonjë dëgjim publik, ose të paktën komuniteti serb nuk ishte në dijeni për këtë. Vetëm njëri theksoi që kishte marrë pjesë në një debat publik për sigurinë, si dhe që nuk mendonte se idetë e tij ishin marrë në konsideratë. Shumica u shprehën se nuk ka angazhim të pjesëtarëve të komunitetit serb në proceset komunale përmes dëgjimeve publike.

*“Fola për disa probleme - ka të rinj që vazhdimisht vijnë, provokojnë, gjuajnë, bërtasin UÇK, e edhe atëherë, isha aty, po flisja për atë që po ndodhte, por nuk kishte mirëkuptim”. **Burrë, 38 vjeç, serb i Kosovës, Rahovec***

Përfaqësuesit komunalë të Rahovecit theksuan mungesën e një kanali televiziv lokal si një nga arsyet kryesore për përqindjen e ulët të pjesëmarrjes së banorëve në dëgjimet publike në përgjithësi. Përveç kësaj, radio-stacioni lokal konsiderohet po ashtu jo fort i popullarizuar, si dhe joefektiv në informimin e njerëzve. Përfaqësuesit deklaruan se edhe pse njerëzit nuk janë aq të informuar për dëgjimet publike ose nismat e tjera të ndërmarra nga komuna e tyre, puna e komunës gjatë pandemisë ishte e kënaqshme.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin shqipfolës në Fushë Kosovë pohuan se kurrë nuk kishin marrë pjesë, ose nuk ishin kyçur në ndonjë dëgjim publik të mbajtur nga komuna e tyre. Shumë nga ta deklaruan se nuk ishin të informuar për dëgjimet publike, ndërsa të tjerët deklaruan se nuk ishte e rëndësishme për ta, ose në interesin e tyre që të marrin pjesë. Vlen të theksohet se pjesëmarrësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës kanë qenë aktivë në dëgjime publike të mbajtura nga komuna para shpërthimit të pandemisë. Pjesëmarrësit nga këto komunitete deklaruan se ishin të informuar për dëgjimet e mbajtura gjatë pandemisë, por theksonin se nuk kishin qenë në gjendje të merrnin pjesë për arsye personale.

*“Kam marrë pjesë në disa dëgjime publike. Herën e fundit që kam qenë, ka qenë para dy vitesh, kur e prezantuan buxhetin. Në atë mbledhje, arritëm të siguronim trotuarin në një rrugë [në zonën tonë]”. **Burrë, 27 vjeç, egjiptian i Kosovës, Fushë Kosovë***

Në përgjithësi, pjesëmarrësit serbë të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në dëgjimet publike në Fushë Kosovë. Ata e dinë që dëgjimi publik ku diskutohet buxheti komunal organizohet të paktën një herë në vit, por asnjëri prej tyre nuk ka marrë pjesë. Disa po ashtu mendojnë se puna e komunës nuk ishte mjaftueshëm transparente, pasi mendojnë se komuna nuk i informon ata për asgjë.

*“Jo, krejt bëhen prapa skene, kështu ndodh, e marrim vesh vetëm pasi të mbarojë, kështu është”. **Grua, 43 vjeçe, serbe e Kosovës, Fushë Kosovë***

Disa pjesëmarrës, këshilltarë të Kuvendit komunal, si pjesë e përfaqësuesve të komunës, deklaruan se komuna e Fushë Kosovës nuk qëndron mirë në aspektin e komunikimit me banorët, pasi nuk mbajnë dëgjime të mjaftueshme publike, me ose pa krizën e COVID-19, prandaj përmirësimi në këtë drejtim është i nevojshëm.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin shqipfolës të fokusit në Zveçan nuk ishin të informuar për ndonjë dëgjim publik që nga fillimi i pandemisë. Sidoqoftë, disa përmendën se ka pasur dëgjime publike të mbajtura para pandemisë, por shumica nuk shfaqën ndonjë interesim për të marrë pjesë.

*"Nuk kam marrë pjesë në asnjë dëgjim publik, sepse kam qenë në pushim të lehonisë. Kam qenë shumë pasive në vitin 2020, në tetor të vitit 2019 mora pushimin, deri në dhjetor të vitit 2020". **Grua, 46 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Zveçan***

Grupi me pjesëmarrës që flisnin serbisht në Zveçan nuk ka marrë pjesë në dëgjimet publike, edhe pse kishin njohuri që ata organizohen. Pjesëmarrësit përshkruan arsyen e pjesëmarrjes së dobët, që informatat nuk ofrohen përmes kanaleve të duhura për të arritur tek ata. Asnjë nga anëtarët e grupit nuk ka marrë pjesë ndonjëherë në dëgjime, ndërsa banorët kontaktojnë me komunën vetëm kur është e nevojshme, për çështje të tilla si regjistrimi i automjeteve.

*"Ndonjëherë kanë ftuar banorët për të kuptuar se çfarë mendojnë për këto projekte, por nuk e di nëse banorët shkojnë atje. Të themi se ka disa projekte ndërtimi, për të cilat duhet të informojnë njerëzit. Kanë komunikim tejet të keq me banorët, me të vërtetë nuk e di, të themi kam dëgjuar "ka qenë dikush, pastaj e dëgjova njërin ...", por asgjë konkrete". **Burrë, 27 vjeç, Serb i Kosovës, Zveçan***

Përfaqësuesit e komunës së Zveçanit pohuan se para pandemisë, kanë organizuar dëgjime publike për të gjitha temat që kanë qenë obligative për t'u prezantuar banorëve, ndërsa ftesat janë vendosur në tabelën e informatave, por edhe janë shpërndarë në media. Gjatë periudhës së COVID-19, komuna kishte organizuar dy dëgjime publike virtuale, për të shmangur grumbullimin fizik, por përfaqësuesit ishin të shqetësuar se banorët e Zveçanit nuk i ishin përgjigjur thirrjeve komunale as për dëgjime publike dhe as për aktivitete vullnetare.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin e fokusit të Podujevës thonin se kurrë nuk kishin marrë pjesë, e as nuk ishin kyçur në ndonjë dëgjim publik të mbajtur nga komuna e tyre. Një nga arsyet kryesore të përmendura nga disa prej pjesëmarrësve ishte që ata nuk ishin të prekur nga problemet ose temat e diskutuara në këto dëgjime. Pjesëmarrësit po ashtu shpjegonin se ishin të informuar për dëgjimet e mbajtura gjatë pandemisë, por nuk kishin ndonjë interesim për t'i ndjekur.


*"Dëgjimet publike në Komunën e Podujevës janë mbajtur gjatë qeverisjes së mëparshme dhe po mbahen tani me qeverisjen e re. Këto diskutime kanë nivel të kënaqshëm; megjithatë, kam një lloj vërejtje: Njerëzit nuk janë aq të interesuar të marrin pjesë në diskutimet publike. Një muaj më parë, mora pjesë në një diskutim publik, si dhe pashë që vetëm ata që ishin të afektuar nga tema e diskutuar merrnin pjesë në diskutimin publik, por jo të tjerët që nuk ndikohen drejtpërdrejt nga temat e diskutuara". **Grua, 27 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Podujevë***

Përfaqësuesit e Komunës së Podujevës deklaruan se kryetari aktual (kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje) ka organizuar dy dëgjime publike për të prezantuar punën dhe përparimin e tij gjatë mandatit të tij 6-mujor, si dhe për të informuar banorët për aktivitetet e ardhshme. Sipas përfaqësuesve, kishte nivel të kënaqshëm të pjesëmarrjes së banorëve gjatë këtyre dy dëgjimeve.

Anketa hulumtoi më tej nëse komunat ishin përpjekur të kontaktonin popullatat e tyre në ndonjë mënyrë tjetër, përveç dëgjimeve publike, që nga shpërthimi i COVID-19. Shumica e banorëve (88%)

në të gjitha komunat pohuan se nuk ishin kontaktuar në asnjë mënyrë tjetër nga komunat e tyre, rreth 10% nuk e dinin/nuk mbanin mend, ndërsa 2% pohuan se ishin kontaktuar. Rreth 16% e banorëve në Zveçan, 4% e atyre në Fushë Kosovë, 3% e tyre në Rahovec, si dhe vetëm rreth 1% e tyre në Prizren thanë se komuna i kishte kontaktuar në mënyra të tjera. Asnjë nga të anketuarit në Podujevë nuk tha të ishte kontaktuar nga komuna në ndonjë mënyrë tjetër.

Figura 42 A ju ka kontaktuar komuna juaj në ndonjë mënyrë tjetër, përveç dëgjimeve publike, që pas fillimit të pandemisë? - sipas komunave



Të anketuarit që ishin kontaktuar nga komuna në ndonjë mënyrë tjetër pas shpërthimit të COVID-19 u pyetën se si ishin kontaktuar. Në total, vetëm 16 prej tyre ishin kontaktuar; tetë sosh përmes telefonatave, duke pyetur për shqetësimet dhe/ose propozimet e tyre, tre përmes anketimit telefonike, dy përmes mesazheve me tekst, si dhe njëri përmes postës elektronike. Katër nga ata që përshkruan mënyrën se si ishin kontaktuar nga komunat e tyre pohuan se i ishin përgjigjur komunës duke folur për shqetësimet dhe propozimet e tyre, shtatë thanë se nuk ishin përgjigjur, ndërsa tre kishin refuzuar të përgjigjen.

Tabela 3 Si ishte bërë kontaktimi? *vetëm ata që ishin kontaktuar nga komuna në mënyrë tjetër, pasi fillimit të përhapjes së pandemisë


	N
Na kanë thirrë në telefon për të pyetur për shqetësimet dhe/ose propozimet tona	8
Ka pasur një anketë për shqetësimet dhe propozimet tona, përmes telefonit	3
Na kanë dërguar mesazhe tekstuale (SMS) për të pyetur për shqetësimet dhe/ose propozimet tona	2
Na kanë dërguar emaila për të pyetur për shqetësimet dhe/ose propozimet tona	1
Asnjë nga më sipër	2
Gjithsej	16

Tabela 4 I jeni përgjigjur komunës duke folur për shqetësimet dhe propozimet tuaja? *vetëm ata që janë kontaktuar me email, SMS, telefonata

	N
Po	4
Jo	7
Refuzuar/Pa përgjigje/Nuk e di	3
Gjithsej	14

Anketa më pas shtjellonte nëse banorët i ishin drejtuar komunës në lidhje me COVID-19, ose ndonjë temë tjetër që nga fillimi i shpërthimit, ku pothuajse të gjithë të anketuarit thanë se nuk e kishin kontaktuar (96%), e vetëm 3% të tyre që i ishin drejtuar. Nëntë përqind e të anketuarve në Zveçan, 8% e tyre në Rahovec, 5% e tyre në Fushë Kosovë dhe 3% e tyre në Prizren thanë se kishin kontaktuar komunën, ndërsa asnjë nga të anketuarit në Podujevë nuk theksonte t'i ishte drejtuar komunës me vetiniciativë.

Figura 43 I jeni drejtuar komunës vetë në lidhje me COVID-19, apo ndonjë temë tjetër, që nga fillimi i shpërthimit? *vetëm ata që nuk janë kontaktuar nga komuna



16 të anketuarit që i ishin drejtuar komunës kishin përdorur mjete të ndryshme komunikimi. Gjashtë prej tyre kishin shkuar fizikisht në ndërtesën e komunës, katër prej tyre kishin thirrur drejtorinë përkatëse në telefon, dy prej tyre kishin dërguar ndonjë familjar në objektin komunës, ndërsa njëri prej tyre kishte shkruar një kërkesë, ndërsa tre prej tyre nuk kishin bërë asnjë nga këto.

Tabela 5 Si ishte bërë kontaktimi? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës

Si ishte bërë kontaktimi?	N
Kam shkuar fizikisht në komunë	6
Kam thirrur drejtorinë përkatëse në telefon	4
Kam dërguar dikë nga familja në komunë	2
Kam shkruar kërkesë	1
Asnjë nga më sipër	3
Gjithsej	16

Tetë nga të anketuarit pohuan se ishte e lehtë të kontaktohet komuna, ndërsa tetë të tjerë mendonin të kundërtën. Nëntë nga të anketuarit pohuan se shqetësimet/propozimet e tyre nuk ishin marrë parasysh, katër prej tyre thanë se ishin marrë parasysh pjesërisht, dy prej tyre pohuan se ishin marrë plotësisht parasysh, ndërsa njëri prej tyre nuk e dinte nëse ishte marrë parasysh ose jo.

Për më tepër, tetë të anketuar pohuan se komuna nuk kishte shpjeguar arsyet pse nuk mund ta plotësonte kërkesën e tyre, katër prej tyre kishin marrë shpjegime të pjesshme, ndërsa njëri prej tyre kishte marrë shpjegim të plotë.

Tabela 6 A janë marrë parasysh shqetësimet apo propozimet tuaja? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës


	N
Jo	9
Po, pjesërisht	4
Po, plotësisht	2
Nuk e di	1
Gjithsej	16

Tabela 7 E ka shpjeguar komuna arsyen pse kërkesa nuk mund të plotësohet krejtësisht/aspak? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës

	N
Jo	8
Po, pjesërisht	4
Po, plotësisht	1
Gjithsej	13

Në vijim, të anketuarve iu kërkua të zgjedhin tri fushat më prioritare ku komuna do të mund të zbuste ndikimet e COVID-19 në jetesën e tyre. Prioriteti i parë ishte ndihma financiare për familjet në nevojë dhe ato të prekura nga COVID-19 (38%), pasuar me subvencionimet e bizneseve (p.sh., lirimi nga taksat, mbështetja financiare, mbulimi i qirave) (8%). 7% përmendën shtrëngimin dhe respektimin e masave kundër COVID-19, 6% përmendën vaksinimin falas të të moshuarve dhe të sëmurëve, ndërsa 5% përmendën përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, e po aq edhe sigurimin e pakove ushqimore.

Figura 44 Ju lutemi na tregoni tri aspektet prioritare më të para në të cilat komuna juaj duhet të përqendrohet për të zbutur dëmet e shkaktuara nga pandemia? - Aspekti i parë i përmendur



Tre aspektet kryesore të përmendura tek **prioriteti i dytë më i rëndësishëm** ishin ndihma financiare për familjet në nevojë dhe ato të prekura nga COVID-19 (19%), shtrëngimi dhe respektimi i masave kundër COVID-19 (10%) dhe ndihma me ilaçe (9%). Ndërsa **tre aspektet kryesore të përmendura tek prioriteti i tretë më i rëndësishëm** ishin shtrëngimi dhe respektimi i masave kundër COVID-19 (9%), ndihma financiare për familjet në nevojë dhe ato të prekura nga COVID-19 (8%) dhe ndihma me ilaçe (9%).

Ofrimi i shërbimeve të rregullta gjatë pandemisë dhe disponueshmëria e mjeteve

Moduli i tretë i anketës ka trajtuar perceptimet e të anketuarve në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të komunave të tyre për reagimin ndaj COVID-19. Për më tepër, ky modul po ashtu hulumton nëse shërbimet publike janë ofruar rregullisht gjatë vitit të parë të pandemisë COVID-19.

Në përgjithësi, mjaftueshmëria e perceptuar e burimeve komunale, në aspektin e mjeteve financiare, personelit të angazhuar dhe infrastrukturën e dedikuar për reagimin ndaj COVID-19, qëndrojnë në nivel mjaft të lartë tek të anketuarit. Shumica besonin se burimet financiare të ndara për reagimin ndaj COVID-19 ishin të mjaftueshme, ndërsa rreth dy të tretat e të gjithë të anketuarve besonin se resurset njerëzore komunale²⁰ si dhe resurset infrastrukturore²¹ ishin të mjaftueshme për reagimin adekuat ndaj COVID-19.

Prizreni dhe komuna e Zveçanit u dalluan në këtë drejtim me më pak banorë të cilët mendonin se burimet financiare dhe njerëzore ishin të mjaftueshme. Sa i përket infrastrukturës, më pak banorë të Rahovecit u shprehën se resurset ishin të mjaftueshme.

Gjetjet sugjerojnë se efektet e pandemisë në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike, si menaxhimi i mbeturinave dhe kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve dhe transporti lokal, por edhe ujësjellës e ndriçim të rrugëve, nuk ishin të rënda. Shumica dërmuese mendonin se shërbimet publike ofroheshin në mënyrë efikase edhe pas shpërthimit të COVID-19. Ofrimi i kujdesit shëndetësor përmes QMF-ve, si dhe pagesa e beneficioneve të skemës sociale u dalluan me pak më pak të anketuar që mendonin se këto shërbime ishin ofruar në mënyrë efikase. Të dhënat të ndara në komuna treguan se kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike në mesin e banorëve të Zveçanit është më e ulët se në komunat e tjera, ndërsa banorët në Rahovec ishin më të kënaqurit në këtë drejtim. Shkaku më i zakonshëm i pakënaqësisë me shërbimet publike ishte joprofesionalizmi dhe mungesa e saktësisë gjatë ofrimit të shërbimeve.

Disa nga diskutimet e grupeve të fokusit treguan nivel mjaft të lartë pakënaqësie me resurset komunale të dedikuara për reagimin ndaj pandemisë. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës shpesh e perceptonin komunën e tyre si dobët të përgatitur dhe pa aftësi të duhura për planifikim, por edhe mungesë të aftësisë efektive për ndarjen e buxhetit. Serbët e Kosovës theksuan buxhetet joefikase dhe ndarjet joefektive, sidomos në lidhje me zonat rurale dhe sektorin e shëndetësisë. Disa perceptonin që buxhetet komunale dhe proceset përcjellëse kishin mungesë transparence. Përfaqësuesit komunalë nga Rahoveci dhe Fushë Kosova pajtoheshin që buxhetet për ngjarje të papritura, si përhapja e pandemisë nuk ishin të mjaftueshme për të zbutur mirëfilli rreziqet dhe pasojat e mundshme. Përfaqësuesit e komunës së Zveçanit pohuan se buxhetet dhe mjetet e tyre ishin joefektive që para fillimit të pandemisë COVID-19.


Kur u pyetën nëse mjetet financiare në dispozicion të komunave të tyre për reagimin ndaj COVID-19 ishin të mjaftueshme ose të pamjaftueshme, 52% e të gjithë të anketuarve menduan se ishin të mjaftueshme - 12% e tyre besojnë se ishin më se të mjaftueshme. Rreth 17% e të anketuarve besuan se ishin të pamjaftueshme.

²⁰përfshirë zyrtarë komunalë, profesionistë shëndetësorë, profesionistë të arsimit dhe nëpunës të tjerë publikë

²¹përfshirë rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësin, kanalizimet, rrjetet elektrike, telekomunikacionet

Gjithsej 34% e të anketuarve në Fushë Kosovë menduan se ishin të mjaftueshme, ndërsa 32% menduan se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 34% menduan se ishin të pamjaftueshme. Gjithsej 51% e të anketuarve në Podujevë menduan se ishin të mjaftueshme, 14% të tjerë menduan se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 32% menduan se ishin të pamjaftueshme. Më shumë se gjysma e të anketuarve në Rahovec (53%) po ashtu mendonin se mjetet financiare në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, por, 42% besonin se nuk janë. Vetëm rreth një e treta e të anketuarve në Prizren (32%) i shihnin mjetet financiare si të mjaftueshme, 11% mendonin se janë më se të mjaftueshme, ndërsa 26% menduan se nuk ishin. Ngjashëm, 32% e të anketuarve në Zveçan besonin se komuna e tyre kishte mjete të mjaftueshme financiare, ndërsa vetëm 2% mendonin se kishin mjete financiare më shumë se të mjaftueshme, ndërsa pothuajse gjysma mendonin se nuk ishin të mjaftueshme (46%).

Figura 45 A janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme mjetet financiare (p.sh., buxheti nga MF, kreditë, donacionet, taksat, etj.) në dispozicion të komunës suaj për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave



Pikëpamjet e burrave dhe grave dallonin pak kur bëhet fjalë për disponueshmërinë e burimeve financiare në komunën e tyre për të ndërmarrë aktivitete si reagim ndaj krizës së COVID-19.

Gjithsej 37% e grave dhe 32% e burrave në Fushë Kosovë menduan se burimet financiare të komunës së tyre ishin të mjaftueshme; por, 42% e burrave dhe vetëm 19% e grave menduan se ishin më se të mjaftueshme. Nga ana tjetër, 44% e grave dhe 26% e burrave ndjenin të kundërtën.

Më shumë se gjysma e grave (52%) dhe gjysma e meshkujve të anketuar (50%) në Podujevë menduan se burimet financiare të komunës së tyre ishin të mjaftueshme, si dhe 15% të tjerë, respektivisht 13%, besonin se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 25% e burrave dhe 28% e grave mendonin se ishin të pamjaftueshme.


Gati dy të tretat e grave (62%) dhe 49% e burrave në Rahovec (53%) besonin se mjetet financiare në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 48% e burrave dhe 28% e grave besonin të kundërtën.

Përkundrazi, më shumë se një e treta e burrave (35%) dhe pak më pak se një e treta e grave (31%) në Prizren mendonin se mjetet financiare në komunën e tyre ishin të mjaftueshme; megjithatë, 13%

e grave dhe 7% e burrave mendonin se ishin më se të mjaftueshme. Shumë më tepër burra (41%) sesa gra (19%) besonin se burimet financiare të komunës së tyre ishin të pamjaftueshme.

Burrat në mënyrë të konsiderueshme më shumë (38%) sesa gratë (9%) në Zveçan besonin se komuna e tyre kishte mjete të mjaftueshme financiare, ndërsa 3% e burrave, e asnjë nga gratë, nuk mendonin se kishin mjete financiare më se të mjaftueshme. Pothuajse dy të tretat (64%) e grave dhe 41% e burrave mendonin se komuna e tyre nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive COVID-19.


Figura 46 A janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme mjetet financiare (p.sh., buxheti nga MF, kreditë, donacionet, taksat, etj.) në dispozicion të komunës suaj për reagimin ndaj COVID-19? - sipas gjinisë



Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse burimet njerëzore të komunave të tyre, përfshirë zyrtarët komunalë, profesionistët shëndetësorë, profesionistët e arsimit dhe nëpunësit e tjerë publikë, janë të mjaftueshme ose të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur pandemisë COVID-19 në nivel lokal. Rreth dy të tretat e të gjithë të anketuarve (65%) besonin se burimet njerëzore komunale ishin të mjaftueshme ose më se të mjaftueshme, ndërsa 26% mendonin se ishin të pamjaftueshme.

Të dhënat e ndara sipas komunave treguan se 73% e të anketuarve në Prizren, 71% e të anketuarve në Fushë Kosovë, 57% e të anketuarve në Podujevë, 54% e të anketuarve në Rahovec, si dhe 52% e atyre në Zveçan mendojnë se burimet njerëzore në dispozicion të komunave përkatëse janë të mjaftueshme ose më se të mjaftueshme. Më shumë të anketuar në Podujevë (41%), Rahovec (40%), si dhe Zveçan (38%) sesa në Fushë Kosovë (28%) dhe Prizren (13%) i konsideruan burimet si të pamjaftueshme.

Figura 47 A janë burimet njerëzore/personeli (p.sh. zyrtarët komunalë, si dhe profesionistët shëndetësorë, profesionistët e arsimit, si dhe shërbyesit e tjerë publikë) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave



Kur krahasohet nga perspektiva gjinore, mund të vërehet se në përgjithësi, më shumë gra sesa burra besojnë se burimet njerëzore në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, me përjashtim të Fushë Kosovës.

Gjithsej 58% e grave, si dhe 52% e burrave, në Prizren mendojnë që burimet njerëzore të komunës së tyre ishin të mjaftueshme. Sidoqoftë, 20% e burrave dhe 16% e grave mendonin se ishin më se të mjaftueshme. Prapë, 22% e burrave dhe 10% e grave mendonin se burimet njerëzore të komunës së tyre ishin të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19.


Një pjesë e mirë e grave (56%) dhe burrave të anketuar (53%) në Fushë Kosovë mendonin se burimet njerëzore të komunës së tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 19%, respektivisht 12%, mendonin se ishin më se të mjaftueshme. Megjithatë, 35% e grave dhe 23% e burrave mendonin ndryshe.

Më shumë se gjysma e grave (54%) si dhe gjysma e meshkujve të anketuar (50%) në Podujevë besonin se burimet njerëzore në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 6% e burrave dhe 4% e grave besonin se ishin më se të mjaftueshme. Pjesë të konsiderueshme të burrave (44%) dhe grave (33%) në këtë komunë i konsideronin burimet njerëzore të pamjaftueshme.

Dy të tretat e grave (66%) dhe 49% e burrave të anketuar në Rahovec (53%) mendonin se burimet njerëzore në komunën e tyre janë të mjaftueshme, ndërsa e kundërt ishte përgjigja për 48% të burrave dhe 21%.

55% të grave, si dhe 41% të burrave në Zveçan mendonin që komuna e tyre kishte burime të mjaftueshme njerëzore, ndërsa 10% e burrave, e asnjë nga gratë, nuk mendonin se kishin resurse njerëzore më se të mjaftueshme. 45% e grave dhe 36% e burrave besonin se burimet njerëzore në komunën e Zveçanit ishin të pamjaftueshme.


Figura 48 A janë burimet njerëzore/personeli (p.sh. zyrtarët komunalë, si dhe profesionistët shëndetësorë, profesionistët e arsimit, si dhe shërbyesit e tjerë publikë) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? – sipas gjinisë



Të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse resurset infrastrukturore të komunave të tyre, përfshirë rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësin, kanalizimet, rrjetet elektrike, telekomunikacionet, e kështu me radhë, janë të mjaftueshme ose të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19. Në përgjithësi, 54% e të gjithë të anketuarve mendojnë se janë të mjaftueshme, e 18% të tjerë besojnë se janë më se të mjaftueshme. Një në katër (25%) e të anketuarve besojnë se resurset infrastrukturore janë të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19.

Një numër i madh prej 86% të të anketuarve në Fushë Kosovë menduan se resurset infrastrukturore janë të mjaftueshme, ndërsa 6% menduan se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 7% menduan se ishin të pamjaftueshme. 48% e të anketuarve në Prizren mendonin se ishin të mjaftueshme, 33% të tjerë menduan se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 16% menduan se ishin të pamjaftueshme. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në Zveçan (52%) pohuan se komuna e tyre ka resurse të mjaftueshme infrastrukturore, ndërsa vetëm 2% thonë se janë më se të mjaftueshme, ndërsa 37% thonë se nuk janë. Më shumë se gjysma e të anketuarve në Podujevë (54%) besojnë se resurset infrastrukturore në komunën e tyre janë të mjaftueshme, 7% mendonin se janë më se të mjaftueshme, ndërsa 37% mendojnë se nuk janë. Më se gjysma e të anketuarve në Rahovec (51%) gjithashtu mendonin se resurset infrastrukturore në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, 1% mendonin se janë më se të mjaftueshme, ndërsa 42% mendonin se ishin të pamjaftueshme.

Figura 49 A janë resurset infrastrukturore (p.sh. rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësi, kanalizimet, rrjetet elektrike dhe telekomunikacionet, kompjuterët, kamerat, skanerët) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave



Pikëpamjet e burrave dhe grave dallonin më shumë në disa komuna sesa në të tjerat, kur bëhet fjalë për mënyrën se si i vlerësojnë resurset infrastrukturore në dispozicion të komunave të tyre.

E njëjta përqindje e burrave dhe grave (86%) në Fushë Kosovë besonin se resurset infrastrukturore aty ishin të mjaftueshme; ndërsa 7%, respektivisht 5%, besojnë se ishin më se të mjaftueshme. Vetëm 9% e grave dhe 5% e burrave besonin të kundërtën.


Më se gjysma e grave (52%) dhe 39% e burrave në Prizren besonin që burimet financiare të komunës së tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 33%, si tek burrat ashtu edhe tek gratë, besonin se ishin më se të mjaftueshme, ndërsa 28% e burrave dhe 11% e grave mendonin se ishin të pamjaftueshme.

Më shume se dy të tretat e burrave (69%), si dhe 36% e burrave në Zveçan mendonin që komuna kishte resurse të mjaftueshme infrastrukturore, ndërsa 3% e burrave, e asnjë nga gratë, nuk mendonin se kishin resurse infrastrukturore më se të mjaftueshme. Pothuajse dy të tretat (64%) e grave dhe 23% e burrave mendonin se komuna e tyre ka burime të pamjaftueshme infrastrukturore.

57% e grave, si dhe 52% e burrave në Podujevë besonin që resurset njerëzore në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 9% të burrave, si dhe 4% të grave, besonin se ishin më se të mjaftueshme. Rreth 39% e burrave, si dhe 35% e grave, mendonin që resurset infrastrukturore të komunës së tyre ishin të pamjaftueshme.


Gati dy të tretat e grave (62%) dhe 46% e burrave në Rahovec besonin se resurset infrastrukturore në komunën e tyre ishin të mjaftueshme, ndërsa 51% e burrave dhe 28% e grave besonin që ishin të pamjaftueshme.

Figura 50 A janë resurset infrastrukturore (p.sh. rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësi, kanalizimet, rrjetet elektrike dhe telekomunikacionet, kompjuterët, kamerat, skanerët) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? – sipas gjinisë



Nga komunat pritet të ofrojnë shërbime publike, pavarësisht nga situata me të cilat ballafaqohen, siç është pandemia COVID-19. Për të kuptuar kapacitetet e komunave në ofrim të atyre shërbimeve, të anketuarit u pyetën edhe për efikasitetin e komunave të tyre në ofrimin e shërbimeve publike. 87% e të anketuarve në të pesë komunat thanë se komuna ishte efikase ose shumë efikase në menaxhimin e mbeturinave, 84% mendonin të njëjtën gjë për menaxhimin e ujërave të zeza, 82% për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, 78% për sigurimin e transportit lokal, 75% për ujësjellësin, 74% për mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve, 70% për ofrimin e shërbimeve shëndetësore përmes QMF-ve, si dhe vetëm 50% për pagesën e obligimeve të skemës sociale.

Figura 51 Pas shpërthimit të COVID-19 në mars të vitit 2020 dhe deri më tani, sa efikase ishte komuna në ofrimin e shërbimeve publike?



Raportimi i këtyre rezultateve për komuna, në shkallë nga 1-5, ku 1 është 'shumë joefikase' dhe 5 nënkupton 'shumë efikase', mund të paraqesë pamje më të detajuar se si njerëzit e shohin efikasitetin e komunave të tyre në kohë të pandemisë.

Të anketuarit nga Rahoveci e vlerësuan efikasitetin e komunës së tyre në kujdesin për menaxhimin e mbeturinave me 4.62, menaxhimin e ujërave të zeza me 4.36, mirëmbajtjen e rrugëve lokale me 4.38, sigurimin e transportit lokal me 3.61, furnizimin me ujë me 4.56, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve me 4.10, ofrimin e kujdesit shëndetësor përmes qendrave mjekësore familjare me 4.01, si dhe ofrimin e detyrimeve të skemës sociale me 4.23.


Të anketuarit nga Prizreni vlerësuan efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave me 4.54 pikë, menaxhimin e ujërave të zeza me 4.39, mirëmbajtjen e rrugëve lokale me 4.19, sigurimin e transportit lokal me 4.27, furnizimin me ujë me 4.02, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve me 3.98, ofrimin e kujdesit shëndetësor përmes qendrave mjekësore familjare me 3.81, ndërsa detyrimet e skemës sociale me 3.64.

Të anketuarit nga Podujeva vlerësuan efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave me 3.62, menaxhimin e ujërave të zeza me 3.87, mirëmbajtjen e rrugëve lokale me 3.90, sigurimin e transportit lokal me 3.53, furnizimin me ujë me 3.71, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve me 3.40, ofrimin e kujdesit shëndetësor përmes qendrave mjekësore familjare me 3.56, ndërsa sigurimin e detyrimeve të skemës sociale me 3.40 pikë.

Të anketuarit nga Fushë-Kosova e vlerësuan efikasitetin e komunës së tyre në kujdesin për menaxhimin e mbeturinave me 4.22, menaxhimin e ujërave të zeza me 3.90, mirëmbajtjen e rrugëve lokale me 4.04, sigurimin e transportit lokal me 4.10, furnizimin me ujë me 3.31, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve me 4.14, ofrimin e kujdesit shëndetësor përmes qendrave mjekësore familjare me 3.81, si dhe ofrimin e detyrimeve të skemës sociale me 3.82.

Të anketuarit nga Zveçani vlerësuan efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave me 3.14 pikë, menaxhimin e ujërave të zeza me 3.34, mirëmbajtjen e rrugëve lokale me 2.9, sigurimin e transportit lokal me 2.54, furnizimin me ujë me 2.66, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve me 3.28, ofrimin e kujdesit shëndetësor përmes qendrave mjekësore familjare me 3.17, ndërsa detyrimet e skemës sociale me 3.28.

Figura 52 Pas shpërthimit të COVID-19 në mars të vitit 2020 dhe deri më tani, sa efikase ishte komuna në ofrimin e shërbimeve publike? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh




Të anketuarit të cilët deklaruan se komuna e tyre ishte joefikase ose shumë joefikase në ofrimin e shërbimeve të lartpërmendura u pyetën tutje pse mendonin kështu.

Për shembull, ata që deklaruan se komuna ishte joefikase ose shumë joefikase në pagesën e detyrimeve të skemës sociale konsideruan se kishte joprofesionalizëm ose mungesë korrektësie, kështu që në përgjithësi ishin të pakënaqur me punën e tyre (29%). Rreth 3% përmendën mungesën e mjeteve financiare, si dhe po aq transparencën dhe informimin e saktë. Gjithsej 24% e atyre që mendonin se furnizimi me ujë ishte joefikas ose shumë joefikas, përmendën se u mungonte furnizimi me ujë të pijshëm. Sa i përket mirëmbajtjes së ndriçimit të rrugëve, 17% kanë përmendur se kanë vërejtur mungesë ndriçimi në hapësirat publike. Disa kanë theksuar arsye të ndryshme për joefikasitetin në ofrimin e kujdesit shëndetësor në nivel lokal; komunës i mungonte ambulanca (14%), shërbimet e dobëta shëndetësore, mungesa e stafit shëndetësor dhe mjeteve bazë shëndetësore (10%), si dhe mungesa e stafit (1%).

Lidhur me çështjet e tjera në të cilat i konsideronin komunat të ishin joefikase, disa i cilësonin rrugët e dëmtuara dhe të pashtuara (8%) si joefikasitet në mirëmbajtjen e rrugëve, 4% përmendën keqmenaxhimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza, etj.

Figura 53 Pse ishte komuna joefikase ose shumë joefikase në ofrimin e shërbimeve të përmendura? *vetëm për ata që thanë se komuna ishte joefikase ose shumë joefikase për të paktën një nga shërbimet e përmendura



Pjesëmarrësve në diskutimet e grupeve të fokusit iu kërkua gjithashtu të diskutojnë nëse mendojnë se komunat e tyre kanë buxhet, infrastrukturë dhe burime njerëzore të mjaftueshme, si dhe nëse janë në gjendje të ofrojnë shërbimet e përgjithshme publike nën kompetencat e tyre.

Sipas shumicës së pjesëmarrësve në grupet shqipfolëse, shumica e komunave nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për të menaxhuar siç duhet situatën e pandemisë, përfshirë komunën e Prizrenit. Disa pjesëmarrës theksuan mungesën e respektimit të ligjeve, planifikimin e dobët dhe ndarjen e buxheteve si disa nga aspektet kryesore në të cilat komuna e tyre nuk është dëshmuar të jetë aq efektive për të zbutur efektet e COVID-19. Për më tepër, disa pjesëmarrës gjithashtu vunë në dukje se situata e shkaktuar nga pandemia ka zbuluar se shumica e shteteve nuk janë të përgatitur për të vepruar siç duhet.

"Nuk mendoj se komuna ka buxhet të mjaftueshëm për COVID-19, sepse dihet që COVID-19 nuk ishte planifikuar më herët që mund të ndodhte, e dihet që gjërat e papritura zgjasin shumë më shumë derisa të arrihet të planifikohet një buxhet i mirë që mund të përballojë çdo fushë që ka prekur COVID-19". Burrë, 21 vjeç, ashkali, Prizren

Grupi serbishtfolës në Prizren nuk ishte i kënaqur me ndarjen e buxhetit, sepse kishte pak projekte që shënjestronin vetëm pakicat. Ata mendonin se shpërndarja e buxhetit nuk ishte planifikuar mirë. Kur bëhet fjalë për profesionistët shëndetësorë në zonat urbane, shumica e pjesëmarrësve mendonin se më parë nuk kishte mjaft punonjës shëndetësorë, por tani me punësimet plotësuese, burimet njerëzore në këtë sektor qëndrojnë në nivel të kënaqshëm. Ata po ashtu ndanin mendimin se ka qenë shumë e vështirë të përballohet mirë pandemia në zonat rurale, si dhe pohuan se nuk ka fuqi punëtore të mjaftueshme që mund të mbështesë luftimin e COVID-19 dhe pasojat e saj.

*"Komuna e Prizrenit kthen suficit prej rreth pesë milionë eurosh në qendër [Ministri të Financave] çdo vit!" **Burrë, 44 vjeç, goran, Prizren***

Kur u pyetën nëse komuna ka qenë efikase në zbutjen e ndikimeve të COVID-19, përfaqësuesit e komunës së Prizrenit pohuan se kanë bërë sa kanë mundur kur bëhet fjalë për shërbimet shëndetësore. Shumica e pjesëmarrësve ishin pozitivë për punën e bërë nga komuna e tyre, por pohonin po ashtu se ndalimi ose tkurrja e disa prej aktiviteteve të planifikuara si pasojë e pandemisë kishte ndikim negativ në zhvillimin e Prizrenit si komunë. Lidhur me ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve publike në mënyrë efikase gjatë pandemisë, shumica e të anketuarve pajtoheshin që edhe pse numri i punonjësve të shërbimeve publike ishte zvogëluar, banorët arrinin gjithsesi të merrnin shërbimet e nevojshme. Sipas tyre, linja telefonike "Alo, Komuna!" konsiderohet mekanizëm shumë i dobishëm gjatë pandemisë.

Shumica e grupit të pjesëmarrësve shqipfolës në Rahovec pajtoheshin që komuna nuk kishte fonde të mjaftueshme për të menaxhuar dhe për të qëndruar mirë në çdo aspekt; buxheti nuk ishte i mjaftueshëm për komunën që të plotësonte gjitha nevojat e saj, e aq më pak për të zbutur dëmet e shkaktuara nga COVID-19. Ndërsa mungesa e stafit mjekësor në ambulanca e spitale në këtë komunë është një nga çështjet kryesore të përmendura në diskutim, pjesëmarrësit u pajtuan se në sektorët e tjerë publikë, stafi është i mjaftueshëm për të ofruar shërbime për banorët e Rahovecit.

*"Sa i përket buxhetit, as unë nuk kam ndonjë informatë për shumën aktuale, por sa i përket pozitave udhëheqëse në shëndetësi, janë bërë disa ndryshime që ishin të domosdoshme (...) infermierët janë rritur në numër, si dhe janë bërë disa ndryshime pozitive. Gjithmonë ka vend për përmirësim, por ka pasur ndryshime, kështu që nuk mund të themi që nuk ka pasur. " **Burrë, 27 vjeç, shqiptar i Kosovës, Rahovec***

Pjesëmarrësit e grupit serbishtfolës në Rahovec po ashtu ndanin mendimin se komuna kishte buxhet shumë të vogël, që nuk mjaftonte për të zbutur pasojat e pandemisë COVID-19. Për më tepër, ata thanë se komuna është shumë e varfër, e madje edhe shqiptarët që jetojnë atje nuk janë ekonomikisht të fortë, ndërsa fuqia blerëse është shumë e ulët. Për më tepër, ata pohuan se nuk kishte mjaftueshëm punonjës shëndetësorë, ilaçe, apo materiale mjekësore në të gjitha pjesët e komunave, pavarësisht nga etnia që i popullon ato.

*"Më vjen shumë keq që nuk ka buxhet të mjaftueshëm, megjithëse çmimet janë shumë të favorshme, të ulëta... Ka shumë gjëra të lira që mund të blihen, e përkundër kësaj, është përsëri e varfër. Nuk e di se çfarë duhet bërë për ta përmirësuar atë". **Grua, 26 vjeçe, serbe e Kosovës, Rahovec***

*"Sa i përket shërbimeve publike, ujit, energjisë elektrike, mbeturinave e kështu me radhë - ka funksionuar normalisht" **Burrë, 38 vjeç, serb i Kosovës, Rahovec***

Përfaqësuesit komunalë të Rahovecit deklaruan se komuna e tyre nuk ka mjete për të vepruar në situata të papritura, siç është kjo me pandeminë COVID-19, ku Kuvendi Komunal mund të ndajë vetëm 10,000 euro nga buxheti pa ndonjë ndihmë financiare nga niveli qendror. Sipas tyre, kjo shumë nuk është e mjaftueshme dhe vetëm përmes donatorëve dhe njerëzve të tjerë që ishin të gatshëm të ndihmonin, mund të rritet efikasiteti i komunës në trajtimin e pasojave të pandemisë. Ata gjithashtu theksuan që komuna e tyre kishte një nga buxhetet më të ulëta në Kosovë, në krahasim me komunat e tjera. Gjithsesi, ata besonin se është bërë punë e madhe, kundruall kapaciteteve.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin shqipfolës në Fushë Kosovë u pajtuan që komuna e Fushë Kosovës nuk kishte fonde të mjaftueshme për të menaxhuar dhe ofruar të mira dhe shërbime publike. Kjo pamjaftueshmëri buxhetore kontribuoi në keqmenaxhimin e situatës së pandemisë në përgjithësi. Duhet të theksohet se ndarja e buxhetit bazohet në shifrat e mëparshme të popullsisë nga viti 2011, ndërsa numri i banorëve në këtë komunë është rritur ndjeshëm ndër vite. Është e qartë për pjesëmarrësit e grupeve të fokusit se buxheti nuk mjafton që komuna të plotësojë të gjitha nevojat e saj, e aq më pak për të zbutur pasojat e shkaktuara nga COVID-19. Ndërsa mungesa e stafit mjekësor në qendra të mjekësisë familjare në këtë komunë është një nga çështjet kryesore të përmendura në diskutim, pjesëmarrësit u pajtuan se në sektorët e tjerë publikë, stafi është i mjaftueshëm për të ofruar shërbime për banorët e Fushë Kosovës.

*"Ne kemi bërë një regjistrim të popullsisë komunale [me një kompani private], ku doli që popullsia është më e madhe se ajo e regjistruar nga qeveria. Kjo ndodh edhe sepse njerëzit që jetojnë në Fushë Kosovë nuk janë të regjistruar në Fushë Kosovë. Pra, vijnë nga qytete të tjera, jetojnë në Fushë Kosovë, por nuk janë të regjistruar këtu. Popullsia në këtë komunë është shumë më e madhe se në vitet e tjera, ndërsa qeveria ndan buxhetin bazuar në popullsinë e mëparshme". **Grua, 27 vjeçe, rome, Fushë Kosovë***

Mendimi i pjesëmarrësve të grupit serbishtfolës lidhur me buxhetin është i ndarë, sepse asnjëri prej tyre nuk ishte i informuar sa duhet për këtë çështje. Disa prej tyre mendonin se kishte buxhet të mjaftueshëm, e disa të tjerë mendonin të kundërtën. Në përgjithësi, grupi ishte i kënaqur me shërbimet që komuna ofron në baza të rregullta, siç është lëshimi i dokumenteve dhe menaxhimi i mbeturinave, ndër të tjera. Pjesëmarrësit besonin se kishte një numër të mjaftueshëm të punëtorëve komunalë, si dhe që ishin efikasë në kryerjen e punëve të tyre, përveç rastit të punëtorëve kadastralë. Për më tepër, ata gjithashtu besonin se kishte mjaftueshëm punonjës shëndetësorë, edhe pse shërbimet shëndetësore perceptohen si jo të organizuara mirë. Prandaj, shumica pohonin se duhej të paguanin për çdo vizitë e trajtim mjekësor në klinika apo laboratorë privatë.

*"Epo, për shembull, secili prej nesh ishte në kontakt me COVID-19, shumë prej nesh edhe u infektuan dhe kur bëmë teste gjaku (...), na u desh të kërkojmë klinikë ose laborator privat" **Grua, 46 vjeçe, serbe, Fushë Kosovë***

Gjatë diskutimit, shumica e përfaqësuesve të komunës së Fushë Kosovës theksuan faktin se buxheti i pamjaftueshëm ka shkaktuar ofrimin e shërbimeve të dobëta për banorët në përgjithësi, veçanërisht në rrethanat e papritura. Për më tepër, buxheti i joadekuat nga qeveria u përmend si arsye tjetër që komuna nuk ka qenë në gjendje të përmbushë të gjitha detyrat e saj. Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve u shprehën se si komunë me fonde të pamjaftueshme, prapë ka arritur të bëjë punë mbresëlënëse gjatë pandemisë. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se kur bëhet fjalë për shërbimet shëndetësore, mbështetjen financiare për grupet e marginalizuara siç janë familjet në nevojë, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, komuna ka bërë çmos. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se gjithmonë ka vend për përmirësimin e shërbimeve dhe ndihmës së ofruar për banorët e saj, megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat dhe buxhetin e ulët në dispozicion, ata besojnë se puna e bërë nga komuna ishte adekuate.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin shqipfolës të fokusit në Zveçan pajtoheshin se në përgjithësi, kishte burime të mjaftueshme financiare, shëndetësore dhe infrastrukturore për të zbutur pandeminë COVID-19, si dhe që ofrimi i shërbimeve publike ishte në nivel.

*"Kemi pasur ndihmë që nga fillimi i pandemisë. Kushdo që ka pasur nevojë për ndihmë sociale është ndihmuar, si me pakot ashtu edhe me gjëra të tjera, kanë qenë efektivë". **Grua, 24 vjeçe, shqiptare e Kosovës, Zveçan***

Pjesëmarrësit serbishtfolës të grupit të fokusit në Zveçan pohuan se buxheti i komunës së Zveçanit nuk është i mjaftueshëm për të zbutur efektet e COVID-19, si dhe disa besonin se edhe sikur të ishte, nuk shpenzohet siç duhet. Ata janë shumë të pakënaqur me kujdesin mjekësor, duke e përshkruar menaxhimin e dobët të shërbimeve mjekësore si arsye kryesore. Për sa i përket burimeve të tjera njerëzore, ata mendonin se kishte numër të mjaftueshëm të nëpunësve dhe punonjësve të tjerë të komunës. Gjithashtu, ata ishin të kënaqur me përpjekjet e komunës për të përmbushur detyrat e saj, për të bërë pagesa sociale dhe për të menaxhuar shërbimet komunale.

*"Epo, unë mendoj se buxheti i komunës së Zveçanit përdoret në mënyrë joracionale. Jam dëshmitar se komuna në Zveçan, këto ditë të ftohta, disa javë më parë, nuk siguroi energji të mjaftueshme për të ngrohur shkollën, duke qenë që është obligim i saj. Por, ka para për disa gjëra të panevojshme, për të vendosur disa tabela që nuk kanë të bëjnë me situatën aktuale e as me fushat ku vërtetë ka nevojë të investohet, por ata i shpenzojnë për gjëra të tilla pa nevojë". **Burrë, 32 vjeç, serb i Kosovës, Zveçan***

Përfaqësuesit e komunës së Zveçanit pohuan se nuk kishin buxhet të mjaftueshëm edhe në rrethana normale. Ata pohuan se buxheti mbulon vetëm pagat për punonjësit dhe asgjë tjetër. Për më tepër,

ata mendonin se nuk kishte numër të mjaftueshëm të punonjësve mjekësorë për të zbutur ndikimet e COVID-19 në shëndetin e banorëve, pasi që asnjë punonjës i ri nuk është punësuar që nga viti 2014. Sipas tyre, problemi më i madh është mungesa e parave për aktivitete të ndryshme, ndërsa komuna priret të varet nga vullneti i mirë i donatorëve dhe vullnetarëve. Përfaqësuesit komunalë gjithashtu e konsiderojnë këtë çështje si brengosëse, si dhe theksojnë numrin e pamjaftueshëm të punëtorëve komunalë si dhe nevojën për t'i dhënë prioritet rritjes së numrit të punëtorëve.

Shumica e pjesëmarrësve në grupin e fokusit në Podujevë ishin të informuar për shumën e buxhetit komunal. Megjithatë, ata u pajtuan që komuna e Podujevës nuk ka fonde të mjaftueshme për të menaxhuar dhe mirëmbajtur organizimin në çdo aspekt. Disa pjesëmarrës pohuan se në të kaluarën, kryetarët e komunave duhej të ishin jashtëzakonisht insistues për të gjetur fonde ose për të përfituar nga niveli qendror, për ofrimin e shërbimeve dhe për të përmirësuar kushtet brenda komunës. Bazuar në opinionet e përbashkëta, keqmenaxhimi i buxhetit komunal ka kontribuar në menaxhimin e pakënaqshëm të situatës së pandemisë.

*“Nuk e di sa ka/sa mund të ketë komuna, por mendoj se nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Flas jo vetëm për komunën tonë, por për të gjitha komunat në Kosovë. Pasi që ka shumë punë, mendoj se buxheti nuk është i mjaftueshëm. Ish-zyrtarët komunalë dhe ish-kryetari i komunës detyroheshin të merrnin me forcë gjëra nga shteti; grante, subvencione, etj., ashtu që të investonin në komunë. Mbase është edhe keqmenaxhim. Mendoj se komunës i duhet më shumë buxhet nga shteti”. **Burrë, 22 vjeç, shqiptar i Kosovës, Podujevë***

Përfaqësuesit e komunës së Podujevës deklaruan se situata për këtë komunë ishte veçanërisht e vështirë, pasi po menaxhonin pandeminë për disa muaj pa kryetar komune, si dhe theksuan se kishin nevojë të përgatiteshin për zgjedhjet dhe kabinetin e ri. Edhe kështu, shumica e pjesëmarrësve u pajtuan se duke marrë parasysh këto gjëra, komuna ka bërë punë të mirë. Disa pjesëmarrës pohuan se komuna e tyre nuk kishte shfrytëzuar të gjithë buxhetin e saj për të zbutur efektet e COVID-19, si dhe u shprehën se fondet e kthyera në fund të vitit 2020 mund të ishin përdorur ndryshe. Tek mallrat dhe shërbimet publike, përfaqësuesit besonin se ishin ofruar në mënyrë efikase. Edhe pse shërbimet publike janë ofruar me staf të reduktuar, të gjithë pjesëmarrësit ishin të bindur për aspektin që nevojat e njerëzve në nevojë ishin përmbushur. Edhe në këtë komunë, linja telefonike “Alo, Komuna!” u përmend si një nga mënyrat më të mira dhe efikase që kjo komunë ka pasur për të komunikuar me banorët e saj, si dhe është dëshmuar të jetë mënyrë e shkëlqyeshme për të adresuar shqetësimet e banorëve dhe për të ofruar ndihmën e nevojshme.

Përfundim

Ky punim hulumton kapacitetet dhe efektivitetin e komunave në Kosovë në përballimin e efekteve të pandemisë COVID-19. Hulumtimi ka vlerësuar nëse banorët komunalë janë të kënaqur me përkrahjen e ofruar nga komunat e tyre përkatëse, nëse kanalet e komunikimit janë vendosur dhe funksionojnë, si dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve publike në kontekstin e pandemisë. Përmes të dhënave të mbledhura, janë matur edhe perceptimet në lidhje me mjaftueshmërinë e financimit komunal dhe angazhimin qytetar.

Të gjeturat e anketës në përgjithësi treguan se shumica e banorëve e konsideronin përkrahjen komunale ndaj tyre dhe familjes së tyre joadeakuatë, ndërsa mbështetja ndaj komuniteteve të tyre është perceptuar si më efikase. Ndihma financiare për familjet e prekura nga pandemia u pa si mënyra më efektive për të mbështetur banorët e komunave që morën pjesë në këtë studim. Subvencionimi i bizneseve dhe rritja e masave kundër përhapjes së COVID-19 u theksuan po ashtu nga një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në sondazh, si mënyra të rëndësishme të mbështetjes në ballafaqim me efektet e pandemisë.

Vetëdijesimi për nismat komunale që synojnë zbutjen e efekteve të pandemisë dallonte. Ndërsa të dhënat e anketës shfaqën nivele përgjithësisht të dobëta të njohurive tek banorët, diskutimi në grupe fokusi zbuloi se disa përfaqësues të komunave, por edhe banorë, mendonin se komunat e tyre kishin zbatuar me sukses një sërë masash zbutëse dhe mbështetëse.

Informatat lidhur me iniciativat komunale për menaxhimin e pasojave të pandemisë, si dhe për dëgjimet publike, duket se ishin të paorganizuar dhe shpesh jo lehtësisht të qasshme. Kjo ka bërë që disa banorë në kategori demografike të caktuara të jenë më pak të informuar se të tjerët (p.sh., të anketuarit që janë pjesë e gjeneratave të moshuara dhe nuk përdorin mediat sociale). Në të kundërtën, informatat e përgjithshme lidhur me COVID-19 janë pranuar përgjithësisht mirë, përmes kanaleve të ndryshme, nga shumica e të anketuarve, si dhe pjesëmarrësit e grupeve të fokusit.

Rezultatet treguan se mungesa e mekanizmave të harmonizuar për shpërndarjen e informatave në lidhje me ngjarjet komunale, si dëgjimet publike, është një nga shkaqet kryesore të niveleve të dobëta të angazhimit qytetar. Ndërsa shumica e komunave kanë mbajtur rregullisht dëgjime publike, siç parashihet me ligjet përkatëse, shumica e të anketuarve mendonin se nuk janë mbajtur dëgjime të tilla. Diskutimi në grupet e fokusit nënvizoi këtë çështje, ku pjesëmarrës të ndryshëm theksonin mungesën e informacionit përkatës dhe kanaleve të duhura të komunikimit midis banorëve dhe komunave të tyre. Niveli i ulët i njohurive lidhur me rëndësinë e angazhimit qytetar u identifikua si pengesë tjetër ndaj mundësisht të ndërveprimeve efektive midis banorëve dhe komunave në Kosovë.

Në përgjithësi, shumica e të anketuarve i perceptonin buxhetet dhe resurset e komunave të tyre për reagim ndaj pandemisë si të mjaftueshme, si dhe nuk kishin parë ndonjë përkeqësim në efektivitetin e ofrimit të shërbimeve publike. Sidoqoftë, gjetje të ndryshme kualitative shfaqën perceptimet e kundërta: buxhetet dhe resurset e pamjaftueshme që nga para pandemisë, mungesa e planifikimit efektiv dhe ndarjeve buxhetore që plotësojnë nevojat e banorëve, mes tjerash, u theksuan si faktorë pengues për reagimin efektiv ndaj pandemisë nga disa prej komunave.

Bibliografia

Garda. Kosovë: Autoritetet freskojnë listën e komunave me aktivitet të shtuar me COVID-19 më 4 dhjetor / shpallja për 2020) (Authorities update list of municipalities with increased COVID-19 activity as of December 4 /update 15")

<<https://www.garda.com/crisis24/news-alerts/407811/kosovo-authorities-update-list-of-municipalities-with-increased-covid-19-activity-as-of-december-4-update-15>>

GZRKS. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12387>>

Instituti Demokratik i Kosovës "Procesi i hartimit të Buxheteve Komunale në Kosovë", 2019. <<https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/02/Municipal-Budget-Development-Process-in-Kosovo-ENG-me-ISBN.pdf>>

Vendimi i Kabinetit Ekzekutiv të Kosovës.

<<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr.01-11.pdf>>

Vendimi i Kabinetit Ekzekutiv të Kosovës.

<<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>>

Vendimi i Kabinetit Ekzekutiv të Kosovës.

<<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendim-i-Mbledhjes-s%C3%AB-16-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>>

Intellinews. Kosova miraton pakon e rimëkëmbjes prej 222.4 milionë € për vitin 2021 (Kosovo approves €222.4mn recovery package for 2021) <<https://www.intellinews.com/index.php/kosovo-approves-222-4mn-recovery-package-for-2021-200482/?source=kosovo>>

UNKT. Rikapitulim i vendimeve të Kabinetit Ekzekutiv të Kosovës (RECAP of Kosovo Executive Cabinet decisions) <<https://drive.google.com/file/d/1mLCGV0Bvgtf91aKvxocwk5PiDmV2U6Jc/view>>

Qendra e situatave, UNKT COVID-19, edicioni (UNKT COVID-19 Update Sitrep).

60<<https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-03/SITREP%2060%20-%20Kosovo%20-26032021.pdf>>

Ministria e Shëndetësisë së Kosovës

<<https://msh.rks-gov.net/sq/kosova-ka-nisur-sot-vaksinimin-kunder-covid-19/>>

Reuters. Kryeministri i Kosovës merr vaksinën e parë kundër COVID-19 për të inkurajuar vaksinimin ("Kosovo PM gets first COVID-19 vaccine shot to encourage take-up")

<<https://www.reuters.com/article/us-health-COVID-19-kosovo-vaccine-idUSKBN2BL2BI>>

Shtojca 1 Metodologjia

Metodologjia për këtë punim hulumtues përfshinte një anketë me 500 të anketuar në pesë komuna në Kosovë, përkatësisht, Fushë Kosovë, Podujevë, Prizren, Rahovec dhe Zveçan. Përveç kësaj, u mbajtën nëntë diskutime në grupe fokusi, me pjesëmarrës shqiptarë dhe serbishtfolës në Kosovë, përfshirë shqiptarë të Kosovës, serbë të Kosovës, romë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptianë të Kosovës, boshnjakë të Kosovës dhe goranë të Kosovës. Pati edhe dy grupe fokusi të mbajtur për secilën komunë, me pjesëmarrës shqiptarë dhe serbë, respektivisht - me përjashtim të komunës së Podujevës, ku kemi mbajtur vetëm një grup fokusi me pjesëmarrës shqiptarë, pasi që pothuajse që nuk ka banorë që flasin serbisht në Podujevë. Për më tepër, u mbajtën edhe pesë diskutime në grupe fokusi me zyrtarët komunalë dhe këshilltarët e kuvendit komunal.

Mostra e Anketës

Anketa u mbajt në Fushë Kosovë, Podujevë, Prizren, Rahovec, dhe Zveçan. Anketa kishte në shënjestër banorët e rritur të këtyre komunave, me qëllim të hulumtimit të angazhimit të banorëve me pushtetin lokal dhe anasjelltas.

Mostra me madhësi proporcionale me përqindjen e popullatës së komunave kundrejt popullsisë së Kosovës do të ishte e mundshme po qe se ky hulumtim do të synonte vetëm analizën e rezultateve apo gjetjeve të përgjithshme të studimit, derisa do të merrte të pesë komunat si entitet i vetëm. Megjithatë, mostra e tillë nuk do të prodhonte rezultate kuptimplote për disa nga komunat, pasi që numri i anketave do të ishte shumë i ulët, duke pasur parasysh që përqindja e popullsisë së tyre kundrejt popullsisë totale të Kosovës është mjaft e vogël. Kështu, studimi ka përdorur mostra kuotë (super-mostra), të cilat kanë çuar drejt madhësisë përfundimtare të mostrës, që përbëhet nga 100 anketa për tri komuna: Fushë Kosovë, Podujevë, Rahovec; 150 anketa për Prizrenin, si dhe 50 anketa për Zveçanin. Megjithatë, kur janë shqyrtuar rezultatet për pesë komunat, kemi aplikuar edhe ponderimin, ashtu që secila komunë të ketë të njëjtën hise, siç paraqiten edhe nga të dhënat zyrtare.

Tabela 8 Mostra e Anketës sipas komunave

Prishtinë	Fushë Kosovë	34.827	2%	9%	20%	100
Prishtinë	Podujevë	88.499	5%	24%	20%	100
Prizren	Prizren	177.781	10%	48%	30%	150
Prizren	Rahovec	56.208	3%	15%	20%	100
Mitrovicë	Zveçan	16.500	1%	4%	10%	50
Totali i 5 komunave		373.815	21%	100%		500
Gjithsej për Kosovë		1.819.907	100%			

²² Shifra e përgjithshme e popullsisë e paraqitur sipër është marrë nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 (ose përlogaritjet me autoritet, kur shifrat e regjistrimit nuk janë të disponueshme), ndërsa lista e votuesve është pasqyrim i personave me shënim në regjistrin civil në komunë. Në disa raste, shifra e listës së votuesve është më e lartë ose e ngjashme me numrin e përgjithshëm të popullsisë për shkak të spastrimit të pamjaftueshëm të gjendjes civile, ose një pjese të konsiderueshme të njerëzve të regjistruar në komunë, por që aktualisht jetojnë diku tjetër ose jashtë vendit. Burimi: OSBE <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279>.

Me një popullsi të përllogaritur prej 373,815 banorësh në këto pesë komuna në Kosovë, bazuar në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, si dhe përllogaritjet e ASK-së, margjina e gabimit për mostrën totale prej 500 intervistash në Kosovë është $\pm 4.38\%$.


Edhe pse mostra kuotë i jepte mjaft të anketuarve mundësinë që të bënin analizë në nivel komunal, rezultatet e përgjithshme në grafik janë paraqitur të ponderuara, për të treguar nivelin aktual përfaqësues të secilës komunë kundrejt popullatës së tërë të të gjitha komunave. Ponderimi është teknikë korigjimi që përdoret nga studiuesit e anketave. Kjo teknikë referohet korigjimeve statistikore që bëhen për të dhënat e anketave, pasi të jenë grumbulluar, për të përmirësuar saktësinë e përllogaritjeve të anketës. Kështu, interpretimi i rezultateve bëhet në të njëjtën mënyrë.

Tabela 9 Procedura e ponderimit

Prishtinë	Fushë Kosovë	34.827	2%	9%	20%	100	9%
Prishtinë	Podujevë	88.499	5%	24%	20%	100	24%
Prizren	Prizren	177.781	10%	48%	30%	150	48%
Prizren	Rahovec	56.208	3%	15%	20%	100	15%
Mitrovicë	Zveçan	16.500	1%	4%	10%	50	4%
Totali i 5 komunave		373.81	21%	100%		500	100%
		5					
		1.819.9					
Gjithsej për Kosovë		07	100%				

Shënim: Rezultatet e përgjithshme në grafik janë paraqitur të ponderuara, e kështu, i tillë është edhe interpretimi i rezultateve.

Profili i përgjithshëm i të anketuarve i përgjigjet përbërjes së përgjithshme demografike në Kosovë, në aspektin e gjinisë dhe moshave. Megjithatë, shpërndarja gjinore dhe moshore për komuna nuk korrespondon me të dhënat e përgjithshme të Kosovës, pasi që ka komuna me më pak/më shumë gra ose burra, si dhe grupmosha. Anketa është kryer me anë të Intervistimit Personal me mjete kompjuterike (CAPI), duke përdorur mostrimin grupues me shumë faza, me stratifikim, përmes tri fazave:



²³ Shifra e përgjithshme e popullsisë e paraqitur sipër është marrë nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 (ose përllogaritjet me autoritet, kur shifrat e regjistrimit nuk janë të disponueshme), ndërsa lista e votuesve është pasqyrim i personave me shënim në regjistrin civil në komunë. Në disa raste, shifra e listës së votuesve është më e lartë ose e ngjashme me numrin e përgjithshëm të popullsisë për shkak të spastrimit të pamjaftueshëm të gjendjes civile, ose një pjese të konsiderueshme të njerëzve të regjistruar në komunë, por që aktualisht jetojnë diku tjetër ose jashtë vendit. Burimi: OSBE <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279>.

Shtojca 2 Lista e Figurave

<i>Figura 1</i> Profili i të anketuarve sipas gjinisë	11
<i>Figura 2</i> Profili i të anketuarve sipas moshës	11
<i>Figura 3</i> Profili i të anketuarve sipas rajonit	11
<i>Figura 4</i> Profili i të anketuarve sipas llojit të vendbanimit	11
<i>Figura 5</i> Profili i të anketuarve sipas shkollimit	11
Figura 6 Profili i të anketuarve sipas Etnisë.....	12
Figura 7 Profili i të anketuarve sipas Punësimit	12
Figura 8 Profili i të anketuarve sipas gjendjes martesore	12
<i>Figura 9</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave	13
<i>Figura 10</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh	13
<i>Figura 11</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas gjinisë.....	14
<i>Figura 12</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas të ardhurave mujore të familjes.....	15
<i>Figura 13</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave	15
<i>Figura 14</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh	16
<i>Figura 15</i> Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni me mënyrën se si ju përkrah komuna juaj (me mjete financiare, donacione në natyrë, apo ndonjë mënyrë tjetër) juve apo familjen tuaj gjatë pandemisë COVID-19? – sipas gjinisë.....	16
<i>Figura 16</i> Çfarë përkrahjeje mungon? Çfarë mund të bëjë më shumë komuna? (pyetje të hapura - të koduara) - sipas komunave	18
<i>Figura 17</i> A dini për ndonjë iniciativë që komuna juaj ka ndërmarrë në lidhje me COVID-19? - sipas komunave	19
<i>Figura 18</i> A dini për ndonjë iniciativë që komuna juaj ka ndërmarrë në lidhje me COVID-19? - sipas gjinisë	19

<i>Figura 19</i> Inicativat e ndërmarra nga komuna në lidhje me COVID-19 - sipas komunave	24
<i>Figura 20</i> Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas komunave	25
<i>Figura 21</i> Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh.....	25
<i>Figura 22</i> Sa të informuar apo të painformuar jeni nga komuna juaj lidhur me pandeminë COVID-19? - sipas gjinisë	26
<i>Figura 23</i> Pse mendoni se nuk jeni informuar mirë, apo nuk jeni fare të informuar? -Sipas komunave *vetëm ata që nuk janë informuar nga komuna e tyre në lidhje me pandeminë COVID-19	26
<i>Figura 24</i> Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga komuna juaj? - sipas komunave	28
<i>Figura 25</i> Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - sipas komunave	28
<i>Figura 26</i> Besimi i informatave të dhëna nga Komuna kundrejt atyre nga institucionet qendrore - në shkallë prej 4 pikave, sipas komunave.....	29
<i>Figura 27</i> Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga: institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - në përgjithësi, sipas gjinisë	29
<i>Figura 28</i> Sa i besoni informatave që merrni për pandeminë COVID-19 nga: institucionet qendrore (p.sh. IKSHPK, Ministria e Shëndetësisë, etj.)? - në përgjithësi, sipas moshave.....	30
<i>Figura 29</i> Si i merrni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - sipas komunave	31
<i>Figura 30</i> Si i merrni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - në përgjithësi, sipas gjinisë.....	32
<i>Figura 31</i> Si i merrni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? – sipas moshave.....	33
<i>Figura 32</i> Si i merrni zakonisht informatat në lidhje me gjendjen, masat dhe përkrahjen e ofruar në komunën tuaj lidhur me COVID-19? - sipas etnive.....	34
<i>Figura 33</i> Sa të lehta për t’u kuptuar ishin informatat lidhur me COVID-19 të ofruara nga komuna juaj (gjuhë e qartë jo-teknike, fotografi/video të përdorura sipas nevojës, mesazhe koncize, etj.)? - sipas komunave	35
<i>Figura 34</i> A ofrohen informatat lidhur me COVID-19 nga komuna juaj në gjuhën tuaj amtare? - sipas etnive	35
<i>Figura 35</i> A ofrohen informatat lidhur me COVID-19 nga komuna juaj në gjuhën tuaj amtare? - sipas komunave	36
<i>Figura 36</i> A ka mbajtur komuna juaj ndonjë dëgjim publik para shpërthimit të COVID-19 (para marsit 2020)? - sipas komunave	41

<i>Figura 37</i> A ka mbajtur komuna juaj ndonjë dëgjim publik pas shpërthimit të COVID-19 (që nga marsi 2020 e deri më tash)? - sipas komunave	42
<i>Figura 38</i> Si jeni informuar për dëgjimet publike pas shpërthimit të COVID-19?	43
<i>Figura 39</i> A e dini sa dëgjime publike janë mbajtur pas shpërthimit të COVID-19?	43
<i>Figura 40</i> Si janë organizuar dëgjimet publike pas shpërthimit të COVID-19?.....	43
<i>Figura 41</i> A keni marrë pjesë në ndonjë nga dëgjimet publike të mbajtura pas shpërthimit të COVID-19? *vetëm rastet kur të anketuarit pohuan se komuna ka mbajtur dëgjim publik pas shpërthimit të COVID-19.....	43
<i>Figura 42</i> A ju ka kontaktuar komuna juaj në ndonjë mënyrë tjetër, përveç dëgjimeve publike, që pas fillimit të pandemisë? - sipas komunave	47
<i>Figura 43</i> I jeni drejtuar komunës vetë në lidhje me COVID-19, apo ndonjë temë tjetër, që nga fillimi i shpërthimit? *vetëm ata që nuk janë kontaktuar nga komuna	48
<i>Figura 44</i> Ju lutemi na tregoni tri aspektet prioritare më të para në të cilat komuna juaj duhet të përqendrohet për të zbutur dëmet e shkaktuara nga pandemia? - Aspekti i parë i përmendur.....	50
<i>Figura 45</i> A janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme mjetet financiare (p.sh., buxheti nga MF, kreditë, donacionet, taksat, etj.) në dispozicion të komunës suaj për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave	52
<i>Figura 46</i> A janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme mjetet financiare (p.sh., buxheti nga MF, kreditë, donacionet, taksat, etj.) në dispozicion të komunës suaj për reagimin ndaj COVID-19? - sipas gjinisë	53
<i>Figura 47</i> A janë burimet njerëzore/personeli (p.sh. zyrtarët komunalë, si dhe profesionistët shëndetësorë, profesionistët e arsimit, si dhe shërbyesit e tjerë publikë) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave.....	54
<i>Figura 48</i> A janë burimet njerëzore/personeli (p.sh. zyrtarët komunalë, si dhe profesionistët shëndetësorë, profesionistët e arsimit, si dhe shërbyesit e tjerë publikë) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? – sipas gjinisë.....	55
<i>Figura 49</i> A janë resurset infrastrukturore (p.sh. rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësi, kanalizimet, rrjetet elektrike dhe telekomunikacionet, kompjuterët, kamerat, skanerët) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? - sipas komunave.....	56
<i>Figura 50</i> A janë resurset infrastrukturore (p.sh. rrugët, hekurudhat, urat, tunelet, ujësjellësi, kanalizimet, rrjetet elektrike dhe telekomunikacionet, kompjuterët, kamerat, skanerët) në dispozicion të komunës suaj të mjaftueshme apo të pamjaftueshme për reagimin ndaj COVID-19? – sipas gjinisë	57
<i>Figura 51</i> Pas shpërthimit të COVID-19 në mars të vitit 2020 dhe deri më tani, sa efikase ishte komuna në ofrimin e shërbimeve publike?	58
<i>Figura 52</i> Pas shpërthimit të COVID-19 në mars të vitit 2020 dhe deri më tani, sa efikase ishte komuna në ofrimin e shërbimeve publike? - sipas komunave, në shkallë prej 5 pikësh.....	59

Figura 53 Pse ishte komuna joefikase ose shumë joefikase në ofrimin e shërbimeve të përmendura?
*vetëm për ata që thanë se komuna ishte joefikase ose shumë joefikase për të paktën një nga shërbimet e përmendura..... 60

Shtojca 3 Lista e Tabelave

<i>Tabela 1</i> E keni marrë këtë informatë në kohën e duhur ose shumë vonë? - bazuar në kanalet e komunikimit që janë shfrytëzuar	34
<i>Tabela 2</i> Cilat kanale të tjera komunikimi duhet të përdorë komuna për të ofruar informata lidhur me COVID-19 në mënyrë që t'ju arrijë më mirë? - pyetje të hapura, sipas komunave.....	36
<i>Tabela 3</i> Si ishte bërë kontaktimi? *vetëm ata që ishin kontaktuar nga komuna në mënyrë tjetër, pasi fillimit të përhapjes së pandemisë	47
<i>Tabela 4</i> I jeni përgjigjur komunës duke folur për shqetësimet dhe propozimet tuaja? *vetëm ata që janë kontaktuar me email, SMS, telefonata	47
<i>Tabela 5</i> Si ishte bërë kontaktimi? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës.....	48
<i>Tabela 6</i> A janë marrë parasysh shqetësimet apo propozimet tuaja? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës.....	49
<i>Tabela 7</i> E ka shpjeguar komuna arsyen pse kërkesa nuk mund të plotësohet krejtësisht/aspak? *vetëm ata që i janë drejtuar vetë komunës.....	49
<i>Tabela 8</i> Mostra e Anketës sipas komunave	67
<i>Tabela 9</i> Procedura e ponderimit	68

Shtojca 4 Karakteristikat Demografike të diskutimit në grupe fokusi

Diskutimet me respondentë në Grup Fokusi

Podujevë

Data: 30.04.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrëse	Gjinia	Mosha	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	30	Bachelor	Punësuar	Shqip
P2	F	26	Master	Punësuar	Shqip
P3	F	27	Master	I papunë	Shqip
P4	M	22	Bachelor	Punësuar	Shqip
P5	F	21	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P6	M	20	Shkollë e mesme	Punësuar	Shqip
P7	M	28	Master	I papunë	Shqip

Fushë Kosovë

Data: 07.05.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrëse	Gjinia	Mosha	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	F	22	Bachelor	Punësuar	Shqip
P2	M	24	Bachelor	Punësuar	Shqip
P3	F	20	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P4	F	20	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P5	M	30	Shkollë e mesme	Punësuar	Shqip

P6	M	27	Shkollë e mesme	Punësuar	Egjiptian
P7	M	49	Bachelor	Punësuar	Rom
P8	F	27	Shkollë e mesme	I papunë	Rom

Data: 21.05.2021

FG 2 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Mosha	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	47	Shkollë e mesme	Punësuar	Serb
P2	F	43	KK	Punësuar	Serb
P3	M	24	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P4	F	18	KK	Punësuar	Serb
P5	M	45	Shkollë e mesme	Punësuar	Serb
P6	F	46	Shkollë e mesme	Punësuar	Serb

Prizren

Data: 29.04.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Mosha	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	F	48	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P2	F	48	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P3	F	31	Bachelor	Punësuar	Shqip
P4	F	23	Bachelor	I papunë	Rom

P5	M	27	Bachelor	I papunë	Rom
P6	M	21	Shkollë e mesme	I papunë	Ashkali

Data: 21.05.2021

FG 2 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Mosh a	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	44	Shkollë e mesme	Punësuar	Gorane
P2	M	48	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P3	M	42	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P4	F	18	Shkollë e mesme	I papunë	Boshnjake
P5	F	19	Shkollë e mesme	I papunë	Boshnjake
P6	F	19	Shkollë e mesme	I papunë	Boshnjake

Rahovec

Data: 21.05.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Mosha	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	38	Shkollë e mesme	Punësuar	Serb
P2	M	27	BA	I papunë	Serb
P3	M	26	BA	I papunë	Serb
P4	F	22	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P5	M	30	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P6	F	24	Shkollë e mesme	I papunë	Serb

Data: 04.06.2021

FG 2 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Mosh a	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	F	30	BA	Punësuar	Shqip

P2	M	21	Shkollë e mesme	Punësuar	Shqip
P3	M	23	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P4	M	48	BA	I papunë	Rom
P5	F	28	KK	Punësuar	Shqip
P6	M	28	BA	Punësuar	Shqip
P7	F	25	BA	Punësuar	Shqip

Zveçan

Data: 12.05.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrëse	Gjinia	Mosh a	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	27	Bachelor	Punësuar	Shqip
P2	M	48	Bachelor	Punësuar	Shqip
P3	F	46	Bachelor	Punësuar	Shqip
P4	M	36	Bachelor	Punësuar	Shqip
P5	F	24	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip
P6	M	27	Bachelor	Punësuar	Shqip
P7	F	21	Shkollë e mesme	I papunë	Shqip

Data: 21.05.2021

FG 2 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrëse	Gjinia	Mosh a	Shkollimi	Punësimi	Etnia
P1	M	32	KK	I papunë	Serb
P2	F	41	KK	Punësuar	Boshnjake
P3	F	20	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
P4	M	40	Shkollë e mesme	Punësuar	Serb
P5	F	29	Shkollë e mesme	I papunë	Boshnjake

P6	M	27	Shkollë e mesme	I papunë	Serb
----	---	----	-----------------	----------	------

Diskutimet në grup fokusi me zyrtarë komunalë dhe këshilltarë të Kuvendit Komunal

Podujevë

Data: 20.04.2021

FG 1 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Pozita në Komunë	Etnia
P1	Mashkul	Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik	Shqip
P2	Femër	Shefe e Sektorit të Regjistrimit të Bizneseve	Shqip
P3	Mashkul	Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë	Shqip
P4	Femër	Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave	Shqip
P5	Mashkul	Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë	Shqip

Zveçan

Data: 20.04.2021

FG 2 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Pozita në Komunë	Etnia
P1	M	Departamenti i Financave/Zyrtar i Shpenzimeve	Serb
P2	F	Këshilltar në Kuvendin Komunal	Serb
P3	M	Udhëheqës i Drejtorisë së Shëndetësisë	Serb
P4	M	Këshilltar Kuvendi/Drejtorja e Shëndetësisë	Serb
P5	F	Qendër biznesi	Serb
P6	F	Këshilltar Kuvendi	Serb

Fushë Kosovë

FG 3 Data: 16.06.2021

Profilet e pjesëmarrësve

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Pozita në Komunë	Etnia
P1	Mashkull	Asamblist i LDK-së	Shqiptar
P2	Femër	Asamblist i LVV-së	Shqip
P3	Mashkull	Asamblist i LVV-së	Shqip
P4	Mashkull	Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, si dhe Shef i Shtabit të Emergjencave gjatë Pandemisë	Shqip
P5	Mashkull	Udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit	Shqip
P6	Mashkull	Asamblist i PDK-së	Shqip

Prizren

Data: 17.06.2021

FG 4 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Pozita në Komunë	Etnia
P1	M	Asamblist i VV-së	Shqip
P2	F	Asamblist i VV-së	Shqip
P3	M	Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik	Shqip
P4	F	Këshilltar Kuvendi	Shqip
P5	F	Këshilltar Kuvendi	Shqip
P6	F	Drejtoreshë e Shëndetësisë	Shqip

Rahovec

Data: 30.06.2021

FG 5 Profili i pjesëmarrësve:

Nr. Pjesëmarrësve	Gjinia	Pozita në Komunë	Etnia
P1	M	Drejtor i Shërbimeve Publike	Shqip

P2	F	Drejtore e Rinisë, Sportit dhe Kulturës	Shqip
P3	M	Drejtore e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit	Shqip
P4	M	Drejtore e Drejtorisë së Shëndetit dhe Kujdesit Social	Shqip
P5	F	Drejtore e Administratës Komunale	Shqip